

SOCIALIZMI

I ZBATUAR:

Revolucioni ideologjik dhe kulturor në Shqipëri dhe mësimet e nxjerra nga historia¹

YLBER MARKU

Abstrakt

I bazuar kryesisht në burime arkivore shqiptare, ky artikull është një analizë krahasuese e Revolucionit Ideologjik dhe Kulturor të mesit të viteve 1960 në Shqipërinë komuniste. Artikulli thekson rëndësinë që pushteti komunist i dha traditës historike të mobilizimeve të masave në vendet e tjera komuniste, kryesisht Revolucionit Kulturor të Maos në Kinë në mesin e viteve 1960 dhe Revolucionit Kulturor të Stalinit në Bashkimin Sovjetik gjatë viteve 1930. Artikulli argumenton se Revolucioni Ideologjik dhe Kulturor krijoi forma të reja legjitimiteti në Shqipërinë komuniste dhe forcoi vazhdimin e politikave që komunistët kishin zbatuar që nga ardhja e tyre në pushtet. Kjo ndryshonte nga lëvizjet e mëhershme në Bashkimin Sovjetik, ku Revolucioni Kulturor kishte pasur si mision themelimin e një qytetërimi të ri, që dallonte thelbësisht nga e kaluara, dhe po ashtu në Kinë, ku Revolucioni Kulturor kinez kishte tiparet e një

¹ Përkthyer në shqip nga Anxhela Çikopano.

lëvizjeje kaotike dhe përcarëse. Artikulli argumenton, gjithashtu, se Partisë së Punës së Shqipërisë iu desh të ripërtërinte traditat krijuese vendase, të zgjedhura me kujdes, si dhe prodhimin kulturor popullor, për të farkëtuar forma legjitimiteti që do t'i mundësonin regjimit të mobilizonte një pjesë të madhe të popullsisë rreth linjës politike të pushtetit. Mobilizimi i masave, i kontrolluar me kujdes, u përqendrua në tri drejtime kryesore: shënjestroi fetë e vendit, duke e shndërruar Shqipërinë në shtetin e parë zyrtar ateist në Evropë; ndërmoi një fushatë të gjerë për emancipimin e gruas; dhe rriti ndjeshëm prodhimin vendas nëpërmjet pjesëmarrjes së masave në punë vullnetare në projekte specifike ekonomike. Megjithatë, kjo lëvizje krijoi shprehje të reja kulturore, hapësira për afirmim personal dhe shpesh edhe për vetëveprim për njerëzit e përfshirë. Së fundmi, artikulli argumenton se Revolucioni Ideologjik dhe Kulturor shqiptar, në vend që të imitonte përvojat kineze dhe sovjetike, iu përgjigj domosdoshmërisë së partisë në pushtet për të çuar përpara synimet e saj politike dhe ekonomike, duke forcuar dhe thelluar gjithashtu kontrollin e partisë mbi shoqërinë.

Fjalë kyçe: *Shqipëria, Revolucioni Ideologjik dhe Kulturor, Bashkimi Sovjetik, Kina, ndërtimi socialist*

I. Hyrje

Kultura dhe revolucioni janë një binom i kudogjendur që nga koha e Revolucionit Bolshevik në Bashkimin Sovjetik.² Në Shqipëri, ashtu si edhe në pjesën tjetër të kampit socialist, përpjekja për të shndërruar një shoqëri masivisht rurale në një

² Sheila Fitzpatrick, red., *Cultural Revolution in Russia, 1928-1931*, Bloomington: Indiana University Press, 1978.

shoqëri socialiste moderne dhe të industrializuar, nënkuptonte edhe shndërrimin e njeriut, rikrijimin e tij ndërsa rikrijohej shoqëria në tërësi. Në dekadën që shtrihet nga mesi i viteve '60 e deri në mesin e viteve '70, sistemi socialist në Shqipëri kapi majën e shndërrimit të tij dhe gjatë kësaj periudhe ideologjia, ekonomia dhe shoqëria u radikalizuan, ndërsa partia përpigëj ta çonte revolucionin drejt një faze pjekurie. Mobilizimi i masave u kthye në një mjet efikas që udhëheqësit komunistë e përdorën shpesh për të farkëtuar një njeri të ri me një mënyrë të re të menduari, ndërsa përdornin fushata masive për të sjellë “ndryshime në bazën shoqërore” që do të nxisnin ndryshimin e mendësisë së popullit, mënyrën se si njerëzit mendonin.³

Në këtë kuptim, përvoja historike e “revolucionit kulturor” në Bashkimin Sovjetik gjatë Planit të Parë Pesëvjeçar Sovjetik (1928-1932) dhe i mëvonshmi Revolucion Kulturor Kinez, që zuri fill në vitin 1966, nuk u lanë pa u përqafuar nga udhëheqësit shqiptarë, për shkak se këto vende kishin tradita të gjata të mobilizimit të masave me synimin e rikrijimit të partisë, individit dhe shoqërisë.⁴ Përvoja sovjetike u shndërrua edhe në

³ Boris Groys, *The Total Art of Stalinism: Avant-Garde, Aesthetic Dictatorship and Beyond*, përkth. Charles Rougle, Princeton, NJ: Princeton University Press, 1992, f. 3.

⁴ Për revolucionin kulturor sovjetik shiko: Sheila Fitzpatrick, red., *Cultural Revolution in Russia, 1928-1931*, Bloomington: Indiana University Press, 1978. Për revolucionin kulturor kinez ekzistojnë qindra botime, mes të cilave shiko: Roderick MacFarquhar dhe Michael Schoenhals, *Mao's Last Revolution*, Cambridge, Mass: Belknap Press of Harvard University Press, 2006; Jicai Feng, *Ten Years of Madness: Oral Histories of China's Cultural Revolution*, San Francisco, California: China Books, 1996; Barbara Barnouin dhe Changgen Yu, *Ten Years of Turbulence: The Chinese Cultural Revolution*, Londër dhe Nju Jork: Routledge, Chapman & Hall Inc, 1993; Paul Clark, *The Chinese Cultural Revolution: A History*, Nju Jork: Cambridge

themelin e eksperimentimit me kultin e personalitetit të udhëheqësit.⁵ Kjo përvojë u ndikua thellësisht nga udhëheqësi kinez Mao Ce Dun, i cili, duke përdorur Librin e Kuq të shkruar prej tij, u kthye në boshtin qendror, rreth të cilit u mobilizuan qindra miliona kinezë për beteja brenda partisë, ndërsa brohoritej nga miliona të tjerë nëpër botë.⁶

Megjithatë, përvoja e Shqipërisë është e ndryshme në qëllim e në shtrirje, edhe për shkak se të gjitha mobilizimet e masave duhen parë në raport me kushtet lokale që burojnë nga trajektore të caktuara historike dhe që vishen nga tradita të

University Press, 2008; Joel Andreas, *Rise of the Red Engineers: The Cultural Revolution and the Origins of China's New Class*, Stanford: Stanford University Press, 2009; Yiching Wu, *The Cultural Revolution at the Margins: Chinese Socialism in Crisis*, Londër: Harvard University Press, 2014; Dongping Han, *The Unknown Cultural Revolution: Educational Reforms and Their Impact on China's Rural Development*, Nju Jork: Garland Publishing, 2000. Për botime më të vona shiko: Tania Branigan, *Red Memory: Living, Remembering, and Forgetting China's Cultural Revolution*, Londër: Guardian Faber Publishing, 2023; shiko edhe kontributin e shkëlqyer të sociologut Guobin Yang, "China's Zhiqing Generation: Nostalgia, Identity, and Cultural Resistance in the 1990s", *Modern China* vëll. 23, nr. 3, 2003, f. 267-296. Një tjetër pikëvështrim mbi revolucionin kulturor kinez vjen së fundmi nga Alessandro Russo, i cili thekson luftën për barazi në fushatën e Maos dhe frikën e Maos se fushata masive mund të shtypej dhe të rivendosej kapitalizmi. Shiko: Alessandro Russo, *Cultural Revolution and Revolutionary Culture*, Durham: Duke University Press, 2020. Filozofi francez Alain Badiou pyet nëse revolucioni kulturor kinez ishte revolucioni i fundit gjatë shekullit XX. Alain Badiou, *The Communist Hypothesis*, Londër dhe Nju Jork: Verso, 2010, f. 101-167. Si Badiou, edhe Russo e shohin revolucionin kulturor kinez si një lëvizje të rëndësishme politike mes shumë të tjerave në shekullin XX, që kërkonte barazi dhe i kundërvihej luftës. Ata dalin edhe në përfundimin se revolucioni dështoi, duke u dorëzuar para fuqisë së kapitalizmi botëror.

⁵ Sheila Fitzpatrick, red., *Cultural Revolution in Russia*.

⁶ Alexander C. Cook, red., *Mao's Little Red Book: A Global History*, Cambridge, MA: Cambridge University Press, 2014.

Socializmi i zbatuar...

rrenjosura në vite. Pas dy dekadash të sundimit komunist, udhëheqësit shqiptarë vendosën të fillonin një fushatë masive mobilizimi, ku do të përfshihej e gjithë shoqëria, për të mbrojtur vijën e partisë nga revizionizmi, ndërsa forcoheshin politikat ekonomike. Ky proces theksonte edhe disa tipare të kulturës lokale dhe promovonte folklorin vendas në art e muzikë. Për ta shtyrë përpara këtë revolucion, regjimi rriti hap pas hapi përdorimin e propagandës masive, jo vetëm si një sistem alternativ të fakteve, por edhe si një mjet stigmatizimi për të përjashtuar pjesë të së shkuarës dhe për të reklamuar të ardhmen e ndritur që shtrihej përpara. Përveç kësaj, regjimi shfrytëzoi edhe fuqinë e rrëfenjave, duke e rishikuar historinë në mënyrë që të ndërtonte narrativa të reja publike mbi të kaluarën për qëllime politike. Mbi gjithçka dhe kudo rrotull njerëzve, shtrohej roli i udhëheqësit Enver Hoxha, si shtysa kryesore drejt centralizimit të pushtetit të partisë dhe themeleve të shëndosha për zhvillime afatgjata (të tilla konsideroheshin prej partisë), që do t'u jepnin formë gjeneratave të tëra të lindura pas Luftës së Dytë Botërore.

Duke hulumtuar Revolucionin Ideologjik dhe Kulturor në Shqipëri, ky artikull thekson rëndësinë që u vuri regjimi traditave historike të mobilizimeve të masave që ishin arritur më parë në vende të tjera komuniste, veçanërisht në Kinë dhe në Bashkimin Sovjetik. Artikulli ngre edhe argumentin që regjimi u detyrua të përkrahte ringjalljen e traditave lokale (të përzgjedhura me kujdes) dhe të produkteve kulturore popullore, për të krijuar forma të reja legjitimiteti, që do ta ndihmonin regjimin të mobilizonte një pjesë të madhe të popullsisë rreth vijës politike të partisë. Megjithatë, lëvizja arriti të krijonte edhe hapësira për afirmim emrash të përveçëm, shpërfaqje të reja kulturore dhe

shpesh edhe fuqizim të njerëzve të përfshirë në to. Së fundi, ky artikull sjell argumentin se kultura, ideologjia, elementet e folklorit kombëtar dhe të nacionalizmit ishin, tekefundit, që të gjitha mjete që partia të pushtonte hapësira të reja në jetën e përditshme të njerëzve, për të forcuar praninë e saj në shoqëri dhe për të kontrolluar edhe sferat personale, gjë që deri në atë pikë regjimi nuk kishte arritur ta bënte.

II. Arsyet e revolucionit dhe fillesat e tij

Shenjat e para të shtytjes së re drejt masave revolucionare u shfaqën në fillim të vitit 1966. Komiteti Qendror i Partisë vendosi të botonte një letër që i adresojë gjithë popullit, përmes së cilës ta përgatiste për masat e nevojshme revolucionare që duheshin ndërmarrë për zhvillimin e mëtejshëm të socializmit. Përgatitjet dhe diskutimet në nivel partiak për këtë lëvizje kishin filluar që në vitin 1965. Duke shpallur se vendi kishte hyrë “në një epokë të re... në atë të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste”, letra më së shumti ishte një paralajmërim kundër manifestimeve të ndikimit të huaj, që nxiste edhe më tej mobilizimin e masave për të arritur synimet politike dhe ekonomike. Letra theksonte gjithashtu të drejtën e masave për të kritikuar zyrtarët e partisë, një thirrje kjo e ngjashme me sesionet e llogaridhënies nga ana e zyrtarëve në Bashkimin Sovjetik e në Kinë. Letra nxiste edhe luftën kundër burokratizmit dhe çmonte të ashtuquajturën “iniciativë revolucionare për të shkuar e për të punuar në prodhim”.⁷ Iniciativa e fundit ngjante me fushatën e

⁷ Mbi përgatitjen e letrës publike adresuar partisë, ushtrisë dhe popullit, në lidhje me rëndësinë dhe të kuptuarin e disa masave revolucionare që kishte ndërmarrë partia, në Dokumente të Byrosë Politike, 9 shkurt 1966, në AQSH,

famshme kineze “T’u ngjitemi maleve e t’u qepemi fushave”, veçanërisht në mobilizimin e miliona nxënësve të zonave urbane, që u dërguan për shumë vite në fshatra të largët gjatë revolucionit kulturor kinez.⁸ Letra shënjoji fillimin zyrtar të fushatës kundër burokratizmit dhe masat revolucionare të përshkruara në letër (përfshirë edhe iniciativën për të dërguar kuadrot të punonin në prodhim) u formuluan hollësisht në kuadër të logjikës së kësaj fushate. Objektivi ishte të ngrihej niveli i edukimit të popullsisë fshatare, ndërsa ndihmoheshin vendasit për prodhimin ekonomik.

Edhe pse ishte pasqyruar gjerësisht në radio, në pankarta, në banderola dhe në të gjitha format e tjera të komunikimit masiv të partisë, të paktën që nga marsi i vitit 1966, tema e Revolucionit Ideologjik dhe Kulturor, u adresua për herë të parë si çështje me rëndësi në raportin e Enver Hoxhës në Kongresin e Pestë të Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSh) në fillim të nëntorit 1966.⁹

F.14, AP-OU, V.1966, D.9, f. 1-16; Tiranë, 4 mars 1966. Letër e Komitetit Qendror drejtuar komunistëve, punëtorëve dhe ushtarëve, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.9, f. 34-62; Tiranë, 4 mars 1966. Minuta të plenumit të partisë, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.9, f. 128-213. Shiko edhe Dokumentet të Byrosë Politike, mars 1966, në Arkivin Qendror të Shtetit (që këtu AQSH), (Fondi) F.14, AP-OU, (Viti) V.1966, (Dosje) D.10. Dokumentet kryesore historike që citohen në këtë artikull në lidhje me Shqipërinë dhe periudhën e saj të komunizmit gjenden në Arkivin Qendror të Shtetit në Tiranë, Arkivi i Partisë (që këtu AP), Organet Udhëheqëse (që këtu OU) dhe Ministria e Arsimit.

⁸ Chen Yi, Ziyang Fan, Xiaomin Gu dhe Li-An Zhou, “Arrival of Young Talent: The Send-Down Movement and Rural Education in China”, *American Economic Review* vëll. 110, nr. 11, 2020, f. 3393-3430. Sipas autorëve 16 milionë nxënës u dërguan në Kinë në zonat rurale, që të ndihmonin me punët lokale. Ata vlerësojnë ndikimin që pati kjo lëvizje në edukimin e fshatarësisë.

⁹ “Mësuesi – përçues i politikës së partisë në fshat, misionar i kulturës së re socialiste”, *Zëri i Popullit*, 8 maj 1966.

Në fjalimin e tij të gjatë prej 323 faqesh, revolucionit kulturor kishte një kapitull më vete, nën titullin “Thellimi i mëtejshëm i Revolucionit Ideologjik dhe Kulturor”, që zinte jo më pak se 43 faqe.¹⁰ Më pas, më 7 shkurt 1967, *Zëri i Popullit*, organ i Komitetit Qendror të partisë, botoi në faqen e parë një fjalim të Hoxhës, drejtuar mbarë popullit. Në këtë fjalim me titullin “Revolucionarizimi i mëtejshëm i partisë dhe pushtetit”,¹¹ përdorimi i fjalës “i mëtejshëm”, nuk ishte i rastësishëm. Më së pari, ai nënkuptonte se Revolucioni Ideologjik dhe Kulturor do të ishte gjithmonë në zhvillim, drejt rrugës së ngritjes së socializmit në vend, një rrugëtim që kishte nisur më 1944 me ardhjen e komunistëve në pushtet, dhe se nuk do të kishte shkëputje nga rendi politik dhe shoqëror i pas çlirimit. Së dyti, ai sinjalizonte se Revolucioni Ideologjik dhe Kulturor do të çonte më tej të gjithë hapat e ndërmarrë në të shkuarën e afërt, madje ishte një vazhdimësi mbase edhe më e ethshme e masave të adoptuara (dhe të adaptuara) nga Bashkimi Sovjetik nën Stalinin dhe nga Kina gjatë viteve të fundit. Dallimet në synime mes revolucionit kulturor në Shqipëri dhe në Kinë janë më se të qarta: Mao donte një fillim të ri për vendin dhe partinë, ndërsa

¹⁰ Raport i Enver Hoxhës në Kongresin e Pestë të Partisë, 1 nëntor 1966, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.1/18 (fletë) f. 213-256. Shiko edhe Dokumente të Byrosë Politike, 10 dhe 11 tetor 1966. Raport mbi punën e Komitetit Qendror që do të mbahet në Kongresin e Pestë të Partisë, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.21, f. 126-151.

¹¹ “Mbledhje e përbashkët e organizatave-bazë të Partisë të Minierës së Qymyrgurit të Krrabës, Uzinës ‘Enver’, Kooperativës Bujqësore ‘Vilhelm Pik’, Repartit Ushtarak nr.5009 dhe Universitetit Shtetëror të Tiranës. Shoku Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, trajtoi temën: ‘Revolucionarizimi i mëtejshëm i Partisë dhe i pushtetit’”, *Zëri i Popullit*, 7 shkurt 1967.

Shqipëria donte të forconte dhe të ngushtonte kontrollin partiak mbi vendin dhe shoqërinë. Për më tepër, fjalimi i Hoxhës u bënte thirrje shtresave më domethënëse të vendit: studentëve, ushtarëve, fshatarëve, punëtorëve dhe intelektualëve. Kjo dallonte nga Kina, ku revolucionin kulturor e kishin promovuar më së shumti rinia shkollore, të paktën në hapat e parë. Në këtë pikë është më se e qartë ngjashmëria me revolucionin kulturor të Stalinit: specialistët dhe jo rinia shkollore ishin ata që e zbatuan revolucionin kulturor sovjetik në vitet '30. Po më e rëndësishmja është se Tirana nuk kishte interes të përdorte një fushatë masive për të krijuar një *tabula rasa* në një vend ku nuk ishte e nevojshme ta bëje këtë.

Njëzet vjet pas vendosjes së regjimit komunist, PPSH-ja i kishte arritur synimet kryesore të vendosjes dhe forcimit të pushtetit. Në marrëdhëniet ndërkombëtare, aleancat vazhdimisht të ndryshueshme të Shqipërisë në fillimet e Luftës së Ftohtë patën ndikim të kufizuar në rolin e partisë në shoqëri dhe në mbajtjen e pushtetit nga ana e udhëheqjes.¹² Pavarësisht ndarjes me Bashkimin Sovjetik në fillim të viteve '60, aleanca me Kinën ishte e qëndrueshme dhe qeveria kineze miratonte shumicën e kërkesave ekonomike të Shqipërisë, veçanërisht ato që lidheshin me ngritjen e një sërë projektesh industriale në mbarë vendin. Gjithashtu, mesi i viteve '60 përkon me kohën kur, për shumë njerëz në Shqipëri, ngritja e socializmit filloi të bëhej e prekshme: shkollat mbërritën në çdo cep të vendit dhe nxënës që vinin nga familje të varfra, filluan të hynin më shpesh në universitete; shërbimi shëndetësor u ofrohej gjithmonë e më shumë njerëzve,

¹² Ylber Marku, "Shifting Alliances: Albania in the Early Cold War", *Journal of Cold War Studies* vëll. 24, nr. 3, vjeshtë 2022, f. 80-115.

edhe pse me shumë mangësi; rreth projekteve ekonomike (industriale) filluan të ngriheshin qytete të reja dhe në dyqane kishte më shumë mallra konsumi se më parë, edhe pse kishte vazhdimisht mungesa të gjithëllojshme dhe periudha e njëfarë begatie nuk do të kishte jetëgjatësi.

Kështu, udhëheqësit shqiptarë nisën një fushatë për të tjera arsye, krahasuar me ato që qëndronin pas revolucionit kulturor në Kinë dhe në Bashkimin Sovjetik. Në Bashkimin Sovjetik, Plani i Parë Pesëvjeçar (1928-1932) u kthye në një mundësi për të vendosur themelet e socializmit dhe për të ndërtuar një qytetërim të ri, me gjithë degëzimet e tij: artin, kulturën, industrinë, hapësirat jetësore, marrëdhëniet e ndryshme shoqërore, një ndërgjegjësim të ri politik dhe, në fund, një formë të re të subjektit politik. Ishte një shkëputje prej gjithë atyre, kundër të cilëve kishin luftuar bolshevikët gjatë Perandorisë Ruse. Nga ana tjetër, revolucionin kulturor kinez ishte më shumë lëvizje shpëtimtare se sa themeluese. Mao ndjeu se i kërcënohej sundimi dhe mendoi që revizionistët e stilit sovjetik mund të merrnin në dorë kontrollin e partisë e pastaj, me gjasë, kapitalizmi mund të rikthehej në Kinë. Prandaj, ai mobilizoi më së shumti të rinjtë e shkollave, që u kthyen në Gardistët e Kuq, kundër po asaj partie që e kishte themeluar vetë. Me thirrjen e Maos për të “bombarduar shtabin” e partisë, revolucionin kulturor kinez u kthye në një fushatë pastrimi (dhe spastrimi), një forcim i linjës së Maos dhe i qëllimeve fillestare të partisë: të ndërtimit të socializmit ashtu siç e konceptonte Mao.¹³

¹³ Yang Jiaqi dhe Gao Gao, *Turbulent Decade: A History of the Cultural Revolution*, përkth. D. W. Y. Kwok, Honolulu: Hawai'i University Press, 1990, f. 93-100.

Nga ana tjetër, Enver Hoxha nuk kishte ndonjë trashëgimi prej së cilës donte të largohej. Spastrimet ndaj revizionistëve pro-sovjetikë në fillim të viteve '60 e kishin garantuar vijueshmërinë e tij politike dhe autoriteti i tij do të vazhdonte të mbizotëronte.¹⁴ Prandaj “e mëtejshme” në deklaratën e partisë tregon përpjekjen për të projektuar bashkimin dhe qëndrueshmërinë e brendshme në vijën e saj politike dhe politikave të zbatueshme, pikërisht pse partia dhe politikave të saj kishin qenë gjithmonë të cenueshme nga zhvillimet e jashtme, që ndodhnin përtej kontrollit të partisë. PPSH-ja ishte gjithmonë vigjilente ndaj trysnisë së jashtme, edhe pse qe përpjekur gjithmonë të merrte rol parandalues në këto zhvillime, duke i kthyer në avantazhin e saj. I tillë ishte, për shembull, rasti i përqafimit të realizmit socialist, që u zyrtarizua pas ndarjes me Jugosllavinë dhe u përmend për herë të parë nga Enver Hoxha gjatë Kongresit të Parë të Partisë Komuniste të Shqipërisë në vitin 1948. Kjo ngjarje shënoi herën e parë që një politikan i nivelit të lartë ka përdorur termin “realizëm socialist” në lidhje me artin dhe letërsinë “e re” shqiptare.¹⁵ Hoxha e përfshiu termin “realizëm socialist” në fjalimin e vitit 1948, thua se stili sovjetik i realizmit socialist ishte përshtatur prej vitesh në Shqipëri, kur, në fakt nuk ishte kështu; thua se njerëzit flisnin prej kohësh për artin shqiptar të realizmit socialist, kur kjo nuk kishte ndodhur.

¹⁴ Ana Lalaj, *Pranvera e Rrejshme e '56-s*, Tiranë: Infbotues, 2015; Elidor Mëhilli, “Defying De-Stalinization: Albania's 1956”, *Journal of Cold War Studies* vëll. 13, nr. 4, vjeshtë 2011, f. 4-56.

¹⁵ “Letërsia jonë duhet të ndjekë rrugën e realizmit socialist”: Diskutime në takimin e Byrosë Politike të KQ të PPSH”, në Enver Hoxha, *Vepra të zgjedhura, Vëll. 2: nëntor 1948 – nëntor 1965*, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1975, f. 179.

Megjithatë, mesi i viteve '60 në Shqipëri ishte një kohë kur duhej vendosur një lloj i ri legjitimiteti, që do të çonte para e do të forconte njëzet vjet pushtet. Ndikimi i Bashkimit Sovjetik vazhdoi edhe pas ndarjes me Moskën, sepse shumica e intelektualëve të vendit ishin arsimuar në shkollat sovjetike dhe të Evropës Lindore. Ndërkaq, aleanca me Pekinin kishte sjellë shumë pikëpyetje në Shqipëri mbi mundësitë e Kinës për ta ngritur nivelin e bollëkut material në atë të Bashkimit Sovjetik, si dhe mbi gatishmërinë e kinezëve për t'i dhënë Shqipërisë një pjesë të tij.¹⁶ Po aq sa ndjekja e sovjetikëve pas sulmeve të Hrushovit ndaj Stalinit dhe nxitjes së reformave, konsiderohej si pengesë për linjën politike të partisë që drejtonte Shqipërinë, që e refuzonte destalinizimin, po aq edhe ndjekja verbërisht e socializmit të modelit kinez në Shqipëri konsiderohej si problematike, duke qenë se mes dy vende kishte dallime të mëdha.¹⁷ Ka disa raporte që shkojnë deri në nivelet e udhëheqjes, që informojnë për pakënaqësinë e njerëzve për përqafimin e

¹⁶ Ylber Marku, "Preparing for an Alliance: China's Socialist Model and Albania's Economic Design in the Early Cold War", *European Review of History* vëll. 30, nr. 3, korrik 2023, doi:10.1080/13507486.2023.2188581.

¹⁷ Mbi politikat sovjetike nën udhëheqjen e Nikita Hrushovit, shiko, mes të tjerave, Melanie Ilić dhe Jeremy Smith, red., *Khrushchev in the Kremlin: Policy and Government in the Soviet Union, 1953-1964*, Nju Jork: Routledge, 2011; William Taubman, *Khrushchev: The Man and His Era*, Nju Jork: Norton, 2003; William J. Tompson, *Khrushchev: A Political Life*, Basingstoke, UK: Macmillan, 1995; Donald A. Filtzer, *The Khrushchev Era: De-Stalinization and the Limits of Reform in the USSR, 1953-1964*, Basingstoke, UK: Macmillan, 1993; Aleksandr Stykalin, "The Hungarian Crisis of 1956: The Soviet Role in the Light of New Archival Documents", *Cold War History* vëll. 2, nr. 1, tetor 2001, f. 113-144; dhe Csaba Békés, "The 1956 Hungarian Revolution and World Politics", CWIHP Working Paper No. 16, Cold War International History Project, Washington, DC, 1996.

mënyrës kineze të të jetuarit në jetën e përditshme.¹⁸ Por të pakënaqur nuk ishin vetëm ata. Edhe vetë Hoxha, ndonëse për arsye të ndryshme nga ato të njerëzve që nuk u pëlqente imitimi i Kinës, në një takim të Byrosë Politike në tetor të vitit 1966, disa ditë para Kongresit të Pestë të PPSH-së, vuri në dyshim revolucionin kulturor kinez dhe sulmoi “kultin antimarksist të Mao Ce Dunit”.¹⁹ Ai i pa ngjarjet në Kinë si pasojë e gabimeve të shumta të Partisë Komuniste Kineze, dhe sidomos e mangësive të saj në analizim dhe në aftësinë e të kuptuarit, si dhe e sulmit të pamjaftueshëm ndaj revizionimit sovjetik. Shqiptarët nuk pajtoheshin me Kinën edhe në mënyrën se si duhej parë figura e Stalinit: për Hoxhën, Stalini nuk kishte bërë gabime, ndërsa për udhëheqjen kineze, Stalini kishte qenë i gabueshëm. Por dallimet më të rëndësishme me Kinën dolën në konceptin e luftës së klasave, pasi kinezët sugjerorin se në fazat e para të socializmit, komunistët duhet të bashkëpunonin me klasën e vjetër borgjeze, ndërsa shqiptarët (Hysni Kapo dhe Mehmet Shehu) mburreshin me faktin se këto klasa në Shqipëri ishin zhdukur.²⁰

Nga perspektiva shqiptare kishte edhe një tjetër ngjashmëri mes sovjetikëve dhe kinezëve: në të dyja rastet problemet e brendshme partiake, krijimi i fraksioneve dhe lindja

¹⁸ Një dokument i diskutuar në Dokumente të Byrosë Politike në fillim të shkurtit 1966, në lidhje me një letër nga një zyrtar ushtarak që në mënyrë anonime kishte goditur regjimin shqiptar, sepse “ndiqte kinezët”. Shiko AQSH, F.14, AP-OU, V. 1966, D. 9, f. 27-30.

¹⁹ Ylber Marku, “China and Albania: The Cultural Revolution and Cold War Relations”, *Cold War History* vëll. 17, nr. 4, 2017, f. 367-383.

²⁰ Dokumente të Byrosë Politike, 10 dhe 11 tetor 1966, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.21, f. 376-408. Për një analizë të mënyrës se si u prit revolucioni kulturor kinez nga udhëheqja shqiptare shiko: Marku, “China and Albania”.

e ndërprerja e një linje të caktuar politike në çastin e ndryshimit të udhëheqjes, e kishin dobësuar partinë dhe fuqinë e saj mbi pushtetin politik. Në rastin e Kinës, ngjarjet kaotike të viteve të para të revolucionit kulturor ishin kambanë alarmi për shqiptarët, pasi në Pekin mund të mbizotëronte revizionizmi e kaosi dhe kjo mund të sillte pasiguri për aleancën shqiptaro-kineze dhe mbijetesën ekonomike të regjimit në Tiranë. Udhëheqësit shqiptarë donin të ndaheshin dukshëm dhe të krijonin një lloj distance nga ndikimet e huaja gjatë regjimit të tyre, qoftë kjo trashëgimia sovjetike apo ndikimi kinez. Kështu, entuziazmi i mesit të viteve '60 përfaqësonte një mundësi për t'i dhënë një shtysë para rolit të partisë në shoqëri, bashkë me përpjekjen për ta veshur regjimin socialist shqiptar me një fasadë në dukje sa më autentike që të ishte e mundur, pa tone sovjetike e kineze, edhe pse që ende thellësisht staliniste. Revolucioni kulturor ishte gjithashtu një moment kur udhëheqja shqiptare kërkoi të thellonte karakterin totalitar të shtetit. Me mobilizimin e vazhdueshëm të masave, termi “totalitarizëm” duhet kuptuar në dy drejtime: kontroll i plotë (total) i partisë mbi masat, në të gjitha sferat e veprimtarisë njerëzore, por edhe pjesëmarrja e plotë (totale) e gjithë shoqërisë në fushata të organizuara me kujdes.

Në këtë kuadër, në mars të vitit 1966, në ushtrinë shqiptare u hoqën befaz gradat dhe u rifutën komisarët politikë.²¹ Në zonat rurale filloi kudo kolektivizimi, edhe aty ku ekonomistët e dinin që ishin zona pa prodhim.²² Për më tepër, thirrjes “kundër burokratizmit në aparatën shtetëror” iu shtua

²¹ Tiranë, 7 mars 1966. Dekret i Presidiumit të Popullit për heqjen e gradave në ushtri, në AQU [Arkivi Qendror i Ushtrisë/AQU], V.1966, D.3, f. 4-9.

²² AQSH, Ministria e Arsimit, F.511, V.1966, D.66.

edhe ajo për një “stil revolucionar në punë”. Qëllimi ishte “çrrënjësja e çdo baze për lindjen e revizionizmit dhe kthimin e rendit kapitalist”, siç kishte ndodhur, sipas PPSH-së, në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera socialiste.²³ Duke ndjekur shembullin e revolucionit kulturor të Bashkimit Sovjetik, Shqipëria vendosi të suprimonte disa ministri. Njëra prej tyre ishte Ministria e Drejtësisë dhe menjëherë pas fjalimit të Hoxhës në Kongresin e Pestë të Partisë, i gjithë sektori i drejtësisë u vu në shënjestër.²⁴ Si pasojë, dhe në vijim të kësaj mase, prokurorët dhe gjykatësit organizuan sa më shumë gjyqe popullore që të mundeshin, jashtë dverve të gjykatave, me pjesëmarrjen aktive të masave. Ky është një shembull i rëndësishëm i pjesëmarrjes së masave në punët e shtetit, përtej iniciativave që kishin synime ekonomike ose edukuese.²⁵ Në Shqipëri, këto masa revolucionare përbënin betejën “për fitoren e ideologjisë socialiste”, që udhëheqja e konsideronte një luftë të gjatë e të vështirë.²⁶

Kjo betejë duhet parë në kontekstin e duhur. Nga pikëvështrimi i udhëheqjes shqiptare, fillimi i revolucionit kulturor në Kinë në verën e vitit 1966, i cili u shoqërua nga skena të dhunshme, mund të jetë dukur fare lehtë edhe si një manifestim

²³ Dokumente të Byrosë Politike, 11 tetor 1966, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.21, f. 83.

²⁴ Tiranë, Dokumente të Byrosë Politike, 10 dhe 11 tetor 1966. Raport mbi punën e Komitetit Qendror që do të mbahet në Kongresin e Pestë të Partisë, në AQSH, F.14, OU, V.1966, D.21, f. 122. Për fjalimin e Hoxhës në Kongresin e Pestë të Partisë ku kritikon sistemin e drejtësisë shiko AQSH, F.14, OU, V.1966, D.1/18, f. 205-206.

²⁵ Dokumente të Byrosë Politike, 11 tetor 1966, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.21, f. 83.

²⁶ Po aty, f. 126-151.

i ri i forcave vetëshkatërruese brenda kampit socialist, si ato që kishin shkaktuar aq shumë telashe dhjetë vjet më parë, gjatë procesit të destalinizimit që u vu në lëvizje nga Hrushovi.²⁷ Vitet e trazirave kishin sjellë paqëndrueshmëri në mbarë Evropën Lindore, dobësimin e theksuar të fuqisë së udhëheqjes komuniste në Hungari, si edhe kërcënime të shndërrimeve të së njëjtës natyrë në Poloni. Po këto ngjarje ndërgjegjësuan udhëheqjen shqiptare se partia duhet të ishte e vendosur drejt thyerjes së çdo forme autonomie individuale, që mund të çonte në papajtueshmëri politike. Për më tepër, shqiptarët pretendonin që, pas vdekjes së Stalinit, Moska e kishte braktisur tërësisht luftën e klasave dhe, së fundi, mendonin që kinezët nuk po e zbatonin atë mjaftueshëm dhe me rigorozitetin e duhur, ndaj kishin frikë se Kina mund t'i dorëzohej revizionizmit dhe ta braktiste krejtësisht luftën e klasave, siç akuzoheshin se kishin vepruar sovjetikët pas vdekjes së Stalinit. Prandaj, lufta e klasave luajti një rol qendror në narrativën e regjimit shqiptar, gjatë promovimit të Revolucionit Ideologjik dhe Kulturor. Në fjalimin e Hoxhës në Kongresin e Pestë të PPSH-së në nëntor të vitit 1966, revolucioni dhe lufta e klasave paraqiten si një “betejë për zemrat

²⁷ Ilic dhe Smith, red., *Khrushchev in the Kremlin: Policy and Government in the Soviet Union, 1953-1964*; Taubman, *Khrushchev: The Man and His Era*; Tompson, *Khrushchev: A Political Life*; Filtzer, *The Khrushchev Era: De-Stalinization and the Limits of Reform in the USSR, 1953-1964*. Për fjalimin kundër Stalinit shiko: Nikita S. Hrushov, *Raport i Komiteti Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik për Kongresin XX të Partisë, Shkurt 14, 1956*, Moskë: Foreign Languages Publishing House, 1956, f. 30-47; Johanna Granville, “Reactions to the Events of 1956: New Findings from the Budapest and Warsaw Archives”, *Journal of Contemporary History* vëll. 38, nr. 2, 2003, f. 261-290.

dhe mendjet e njerëzve”.²⁸ Gjithsesi, Hoxha i referohet qartë Revolucionit Ideologjik dhe Kulturor si një *vijimësi* e luftës së klasave porse *në frontin ideologjik* dhe, në mënyrë domethënëse, *në gjirin e popullit*. Me fjalë të tjera, shënjestra kryesore e luftës së klasave nuk do të ishin më vetëm *armiqtë e mirëfilltë të klasës*, por mbeturinat e ideologjisë mikroborgjeze *në mendjen dhe ndërgjegjen e vetë komunistëve*. Kjo ishte përgjigja e Hoxhës ndaj mospajtimeve me kinezët gjatë vizitës së kryeministrit Mehmet Shehu në Kinë në prill të vitit 1966: vazhdimi, objekti dhe terreni i zhvillimit të luftës së klasave në Shqipëri.²⁹ PPSH-ja nuk donte të pranonte që në Shqipëri kishte ende klasa armiçësore (të cilat Hoxha pretendonte se i kishte eliminuar), ndaj udhëheqja e ktheu luftën e klasave kundër *mbeturinave* të klasave armiçësore dhe e kaloi në sferën *ideologjike* (dhe kulturore). Po ashtu, ndryshe nga Mao me Partinë Komuniste Kineze, Hoxha nuk donte ta fuste luftën e klasave brenda PPSH-së, ndaj e çoi atë te masat që udhëhiqeshin nga partia. Por këtë mund ta bënte përmes një beteje në rrafshin ideologjik dhe kulturor. Konkretisht kjo donte të thoshte se fati i komunizmit në Shqipëri do të varej nga ndërtimi i njeriut të ri socialist, një pozicion tërësisht stalinist, gjë për të cilën Hoxha nuk mund të mos ketë qenë i ndërgjegjshëm. Korniza kohore ishte e rëndësishme. Një brez të rinjsh që kishin lindur pas Luftës së Dytë Botërore po përgatiteshin t’i shërbenin ekonomisë dhe shoqërisë. Disa mijëra po përfundonin universitetin dhe shpejt do të merrnin pozicione ekonomike, administrative dhe politike në

²⁸ Dokumente të Byrosë Politike, 11 tetor 1966, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.21, f. 129.

²⁹ Marku, “China and Albania”.

mbarë vendin. Ata duhet të formësoheshin edhe një herë dhe të bëheshin gati për t'i shërbyer revolucionit e partisë me një frymë të re.

Faktorët politikë ishin vetëm një pjesë e shtysave pas Revolucionit Ideologjik dhe Kulturor në Shqipëri. Të tjerë faktorë lidheshin me fuqinë punëtore që nevojitej për realizimin e projekteve ekonomike, prandaj mijëra njerëz kaluan nga detyrat administrative në njësitë e prodhimit. Përpjekja për industrializimin e vendit kishte përparuar deri në atë pikë që, në sajë edhe të ndihmës kineze, në mbarë vendin u realizuan qindra projekte infrastrukturore e industriale. Në fillim sovjetikët, e më pas edhe kinezët kishin shfaqur dyshime mbi realizueshmërinë e planeve ekonomike të Hoxhës me impiante të mëdha industriale, që kërkonin fuqi të specializuar punëtore dhe krah masiv pune, të cilat Shqipërisë i mungonin. Ndaj, ky revolucion ishte edhe një lëvizje që synonte arritjen e objektivave ekonomikë që kërkonin fuqi punëtore, në një vend ku shumë punë bëheshin pa mjete të motorizuara përmes të ashtuquajturave *aksione*. Prandaj, mund të themi që ky revolucion në Shqipëri, po zëvendësonte, sidomos në rastin e disa projekteve specifike, mungesën e teknologjisë e të pajisjeve të përshtatshme.

Motivimi i masave dhe përfshirja e tyre në aksione ndihmoi në realizimin e një sërë projektesh, të tilla si hekurudha, kantiere për impiantet industriale, diga e rrugë, një proces gjatë së cilit theksohej figura e punëtorit dhe shpirti i sakrificës.³⁰ Lëvizja ishte politikisht e rëndësishme, sepse godiste një prej elementeve që shqiptarët mendonin se kishte sjellë lindjen e

³⁰ Dokumente të Byrosë Politike, 11 tetor 1966, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.21, f. 84.

revizionizmit në Bashkimin Sovjetik të udhëhequr nga Hrushovi. Problemi lidhej me dallimet e reja klasore që kishin dalë në pah me ardhjen në fuqi të Revolucionit Bolshevik. Roy Medvedev shkruan se Lenini, në ditët e fundit të jetës së tij, shkroi disa artikuj të shkurtër që nxisnin luftën ndaj burokratizmit.³¹ Dallimi klasor kishte qenë problem që në fillimet e revolucionit sovjetik, që Stalini ishte përpjekur ta ndalte, duke goditur privilegjet e intelektualëve në vitet '30.³² Duke sulmuar këtë klasë krijohesh hapësirë për rritje shoqërore të njerëzve të klasës punëtore, që ngriheshin në detyrë, duke u dhënë punë jashtë fabrikave e duke i futur në menaxhim e administrim. Kështu, duke forcuar luftën e klasave, burokratët dhe profesionistët e të gjitha fushave në Bashkimin Sovjetik u konsideruan një barrë që duhej hequr, prandaj u fshinë pozicione të tëra. Po njësoj, edhe në Shqipëri gjatë fushatës kundër burokratizmit, që synonte t'i afronte që të gjithë me klasën punëtore, mijëra mësues, burokratë, punonjës shtetërorë të niveleve të ndryshme, artistë, shkrimtarë dhe profesionistë u dërguan për periudha të shkurtra në fushata të organizuara, që të ndihmonin në prodhim në fabrika e kooperativa. Por lëvizja më thelbësore, që zgjati më shumë në kohë, ishte pranimi i qindra punëtorëve në universitete apo kalimi i tyre në punë të administratës e në detyra teknike.

Nga ana tjetër, mbi popullsinë e fshatit u zbatua kolektivizimi i bujqësisë e blegtorisë. Para se komunistët të vinin në pushtet, Shqipëria kishte një numër relativisht të vogël pronarësh tokash dhe pronat e tyre u ishin shpërndarë fshatarëve

³¹ Roy Medvedev, *Let History Judge: The Origins and Consequences of Stalinism*, përkth. George Shriver, revised and expanded edition, Nju Jork: Columbia University Press, 1989, f. 99-100.

³² Fitzpatrick, *Cultural Revolution in Russia*, f. 38.

nga fundi i viteve '40. Megjithatë, partia propozoi dhe detyroi zbatimin e kolektivizimit, si një mënyrë për të eliminuar dallimet mes fshatarëve dhe atyre që u shpallën si kulakë, duke e legjitimuar luftën e klasave mbi baza ideologjike. Në fund, partia forcoi edhe institucionet e saj për debate politike e letrare, të cilat përshkoheshin nga një frymë e theksuar ideologjike, e cila theksonte me tone gati profetike rëndësinë e bashkimit rreth partisë, duke kufizuar sa më shumë të ishte e mundur hapësirat për debate të pavarura.

Partia bëri gjithashtu të detyrueshëm edhe edukimin politik për të gjithë klasën teknokratike të vendit, profesionistë të të gjitha fushave që gëzonin njëfarë lirie në mënyrën e të menduarit. Vendimi mund të lidhej, veç arsyeve të tjera, me ngjarjet në Kinë. Në Tiranë po mbërrinin raporte shqetësuese, që tregonin se partia komuniste kineze ishte në kaos, ndaj Hoxha doli në përfundimin se “atje [në Kinë] organizata e partisë është e paralizuar dhe nuk arrin as të udhëheqë revolucionin kulturor”.³³ Edhe kur situata në Kinë u qartësua dhe u pa që Mao e kishte nxitur këtë fushatë masive për të shpëtuar Kinën (dhe pushtetin e tij) nga kërcënimi i revizionizmit, shqiptarët mendonin që Kina e kishte arritur këtë “përmes rrugësh e metodash të padëgjuaara më parë”.³⁴ Prandaj Revolucioni Ideologjik dhe Kulturor i Shqipërisë ishte mes të tjerave edhe një *reagim* ndaj revolucionit kulturor kinez, jo dhe aq një zgjatim i tij sesa një ndarje prej tij. Në këtë pikë, duhet të vërejmë që, në

³³ Tiranë, 10 tetor 1966. Transkript i takimit “Shënime të Enver Hoxhës mbi Revolucionin kulturor kinez” në Dokumente të Byrosë Politike, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.21, f. 376-408; Marku, “China and Albania”.

³⁴ Mbi zhvillimin mëtejshëm të revolucionit kulturor kinez (Enver Hoxha, Qershor 1967), në AQSH, F.14, AP-OU, V.1967, D.1, f. 192 & f. 211.

fillimet e revolucionit kulturor kinez, duke parë turbullirat dhe dhunën e Gardistëve të Kuq kundër partisë në Kinë, udhëheqësit shqiptarë e morën seriozisht parasysht mundësinë e mposhtjes së vijës së Maos dhe rënien e vendit në revizionizëm. Ka gjasë që, në tetë muajt që ndajnë letrën e hapur të Komitetit Qendror të Partisë në fillim të marsit 1966 dhe fjalimit të Hoxhës në Kongresin e Pestë të Partisë në nëntor të vitit 1966, dhe në tre muajt mes Kongresit të PPSH-së dhe fjalimit të Hoxhës në shkurt të vitit 1967, kohë gjatë së cilës PPSH-ja në Shqipëri po merrte gjithmonë e më shumë informacione rreth revolucionit kulturor kinez, Hoxha të ketë vendosur t'i zgjerojë masat revolucionare që ishin ndërmarrë në kuadrin e fushatës kundër burokratizmit, duke prezantuar fushata të reja që përshkoheshin nga shpirti i vijës së masave, që dukej se ishte në themel të revolucionit kulturor kinez, por duke i përshtatur sipas kushteve shqiptare. Kësisoj, u arrit një lloj kompromisi mes politikës së jashtme e të brendshme dhe konsideratave ideologjike. Prandaj, politikisht, Revolucioni Ideologjik dhe Kulturor në Shqipëri e forcoi më tej rolin e partisë dhe të udhëheqësit të saj Enver Hoxha, për të rritur kontrollin e tyre mbi vendin në rast se Kina nuk e ruante kursin e saj ideologjik me Shqipërinë, atë që solli fillimisht edhe lidhjen e fortë mes tyre. Megjithatë, kjo duket më shumë si rezultat i revolucionit, se sa një politikë e qëllimshme e menduar mirë që në zanafillë. Gjithsesi, eventualisht, udhëheqja shqiptare e konsideroi revolucionin kulturor kinez si “një revolucion i rëndësishëm politik” dhe duke mësuar nga gabimet e Kinës, ku revizionizmi kishte hedhur rrënjë, në Shqipëri udhëheqja “mori masa që ta parandalonte lindjen e revizionizmit”.³⁵ Prandaj,

³⁵ Po aty, f. 192 & f. 213.

revolucionit shqiptar ishte mbi të gjitha një fushatë masive për të arritur qëllime politike, duke bërë pjesëmarrëse edhe masat, për të treguar në fund se “diktatura e proletarietit është padyshim pushteti i masave”.³⁶

III. Revolucioni në veprim: arti dhe krijimtaria

Në fillimet e revolucionit kulturor kinez, Hoxha bëri kujdes që të citonte Leninin – se kultura proletare mundësohet kur ajo ndërtohet mbi prodhimin kulturor të stadeve të mëparshme zhvillimore, përfshirë kapitalizmin – dhe të sulmonte konceptin e *tabula rasa* të Kinës.³⁷ Ai pretendonte se në Shqipëri revolucioni kulturor synonte të ngrihej mbi të shkuarën, duke e analizuar në mënyrë kritike atë, për të kuptuar dhe theksuar të tashmen socialiste. Për shqiptarët, pa të shkuarën, njeriu komunist nuk do të ishte tjetër veçse “një njeri i zbrazët”.³⁸ Në të njëjtën kohë, udhëheqja shqiptare kritikonte intelektualët për shkëputjen nga masat dhe nënvleftësimin që ata kishin ndaj punës fizike që kryenin fshatarët dhe punëtorët. Prandaj “njerëzit e shkencës, artit dhe kulturës, duhet të jenë nxënës të një mësuesi të madh e të pagabueshëm: popullit”.³⁹ Në fakt, ai nënkuptonte që njerëzit e artit e shkencës duhet të ishin nën varësinë e partisë dhe se “letërsia dhe artet duhet të ktheheshin në armë në duart e

³⁶ Po aty, f. 192 & f. 217.

³⁷ Dokumente të Byrosë Politike, 10 dhe 11 tetor 1966, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.21, f. 394-396.

³⁸ Dokumente të Byrosë Politike, 10 tetor 1966, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.21, f. 396.

³⁹ Dokumente të Byrosë Politike, 11 tetor 1966, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.21, f.134-135.

partisë, për të edukuar punëtorët me shpirtin e socializmit”.⁴⁰ Një theks i veçantë në këtë kohë u vendos mbi zhdukjen e atyre që u konsideruan “shfaqje të huaja” në art dhe letërsi. Në një raport të Byrosë Politike në tetor të vitit 1966, disa teatro dhe opera u akuzuan se po vinin në skenë vepra të huaja dhe të së shkuarës, kurse në letërsi po “përktheheshin autorë të huaj të dyshimtë dhe në kinema shfaqeshin filma të rrezikshëm”. Raporti kërkonte krijimin e artit dhe letërsisë revolucionare të realizmit socialist.⁴¹

Edhe pse ky drejtim i centralizuar mbi punën kulturore dhe letrare e ngushtoi kornizën e debatit intelektual, ishte pikërisht periudha e fundviteve '60 dhe fillimviteve '70 që solli debate relativisht të hapura në Shqipëri, veçanërisht në faqet e gazetës *Drita*, mbi çështjen nëse letërsia duhet të ndiqte rrugën e realizmit socialist (sovjetik) apo nëse duhet të merrte një tjetër drejtim pas ndarjes me sovjetikët. Kjo atmosferë debati relativisht të hapur u reflektua edhe në organizimin e një cikli leksionesh mbi ekspresionizmin, Van Gogun, si dhe rryma e autorë të tjerë modernistë, në Institutin e Lartë të Arteve, paqka se me synimin e të kritikuarit e hedhjes poshtë, por që gjithsesi dëshmon se, të paktën në artet pamore, kjo ishte periudha e një debati të gjerë intelektual.

Në letërsi, njeriu i thjeshtë, si minatori, punëtori, ushtari, kooperativisti dhe në përgjithësi heroi pozitiv u bënë qendra e narrativës, krahas figurave historike e patriotike, me shkrimtarë që, të udhëhequr nga parimet e realizmit socialist, shpesh i bënë

⁴⁰ Po aty, f. 138-139. Shiko edhe: Raport i Enver Hoxhës në Kongresin e Pestë të Partisë, 1 nëntor 1966, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.21, F.1/18, f. 234.

⁴¹ Dokumente të Byrosë Politike, 11 tetor 1966, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.21, f. 141.

jehonë retorikës politike.⁴² Figura si elektrikisti që u sillte rrymën elektrike fshatrave të largët, çka si alegori, simbolizonte edhe dritën e partisë; minatori që arrinte të nxirrte mineralet aq të rëndësishme për modernitetin ekonomik socialist; punëtori i hekurudhës, traktoristi dhe të tjera figura profesionistësh që lidheshin me përparimin ekonomik në socializëm, u kthyen në personazhet kryesore të arteve pamore. Mbizotërimi i kësi figurash ishte edhe një dëshmi e faktit se moderniteti mbërriti në Shqipëri më vonë se në vendet e tjera socialiste të Evropës. Elektrifikimi dhe industrializimi ishin dy procese që përfunduan në Shqipëri gjatë viteve '60-'70, katër dekada më vonë se në Bashkimin Sovjetik. Ideja e modernitetit socialist në Shqipëri fillimisht bazohej në modelin sovjetik stalinist dhe në përvojën historike të viteve '30 në Bashkimin Sovjetik, por u arrit gjatë periudhës së maoizmit. Kjo do të thotë se elementet kineze maoiste iu mbivendosën dhe iu shtuan modeleve të mëhershme sovjetike staliniste, që, me sa duket, nuk u braktisën kurrë tërësisht.

Edhe në artet pamore, veçanërisht në pikturë, u ngrit një narrativë e re: pritshmëria optimiste e një të ardhmeje të ndritur, që shpesh nxirrej në pah nga ngjyra dhe kontraste të forta.⁴³ Gjatë

⁴² Raino Isto argumenton se lëvizja nga një aleancë në tjetrën solli një përpjekje për të krijuar art origjinal që do të ndikohej më pak nga Bashkimi Sovjetik (ku kishin studiuar shumë prej këtyre artistëve), ndërsa përpiqeshin të lidheshin me realitete të tjera si Kina dhe Lindja e Largët në përgjithësi. Shiko: Raino Isto, "Between Two Easts: Picturing Global Socialism in Albanian Post-War Art, 1959-69", *Art History* vëll. 45, nr. 5, f. 1058-1077, doi: 10.1111/1467-8365.12686.

⁴³ Në Shqipëri, shumë prej pikturave të periudhës mes fillimit të viteve '60 dhe fundit të viteve '70, mund të shihen në Galerinë Kombëtare të Arteve. Një botim interesant i viteve '90 me ilustrime mbi pikturën në Bashkimin Sovjetik

këtyre viteve, gjetja e një rrugëdaljeje nga vështirësitë e së shkuarës ishte një motiv kurdoherë i pranishëm në tekstet letrare, teksa “u rizbulua” dhe u theksua edhe letërsia e epokës para komuniste, që nxirrte në pah varfërinë e mjerimin e shqiptarëve para socializmit, por edhe dëshirën për progres e për çlirimin kombëtar (siç është rasti i Migjenit). Por letërsia, edhe pse ishte një ndër artet më parësore në Shqipërinë socialiste, u shkëput nga pjesa tjetër e kampit euro-sovjetik, ku ndodhnin shkëmbime mes shkrimtarëve, madje edhe konferenca që rehabilitonin autorë të ndaluar.⁴⁴ Megjithatë, ka pasur një përpjekje të ndërgjegjshme për të zgjeruar qëllimisht subjektet dhe temat e shndërrimit revolucionar të shoqërisë socialiste, që të kishte më shumë artistë që të merreshin me të përditshmen, folklorin dhe luftën partizane. Kësisoj, izolimi solli krijimin e një realizmi socialist lokal shqiptar. Sikurse pohonte edhe Katarina Clark kohë më parë, ashtu siç ka disa forma të komunizmit, ka edhe shumë forma të realizmit socialist.⁴⁵

gjatë kohës së Stalinit është Gleb Prokhorov, *Art Under Socialist Realism: Soviet Painting 1930-1950*, Roseville East, Australi: Craftsman House, 1995.

⁴⁴ Hans Günther, “How Socialist Realism was Exported to Eastern European Countries and How They Got Rid of It”, në Evgeny Dobrenko dhe Natalia Jonsson-Skrodol, red., *Socialist Realism in Central and Eastern European Literatures: Institutions, Dynamics, Discourses*, Nju Jork: Anthem Press, 2018, f. 21-23. Një studim gjithëpërfshirës mbi letërsinë e gjerë sovjetike që ilustron me shembuj realizmin socialist është i Katerina Clark, *The Soviet Novel: History as Ritual*, Chicago dhe Londër: The University of Chicago Press, 1981. Për studime më të hershme të realizmit socialist në letërsinë e Bashkimit Sovjetik shiko: C. Vaughan James, *Soviet Socialist Realism: Origins & Theory*, Londër dhe Basingstoke: Palgrave Macmillan, 1973.

⁴⁵ Clark, *The Soviet Novel*. “Realizimi socialist,” pohon ajo, “është në thelb një emër i zbatuar në sistemin letrar të kulturës sovjetike, se sa një mënyrë të shkruari specifikisht ‘socialiste’ apo ‘realiste’” (f. 9). Teoria e realizmit

Realizmi socialist i Shqipërisë ishte lokal, sepse pavarësisht se format e krijimtarisë u ngjanin atyre të Bashkimit Sovjetik gjatë viteve '30 e më pas, në dallim nga Bashkimi Sovjetik, nuk i kundërviheshin traditës, por synonin ta rikrijonin narrativën e saj në interes të farkëtimit të ndjenjave të forta nacionaliste.⁴⁶ Toka e të parëve dhe gjaku i përbashkët shqiptar u bënë ndër temat e preferuara në art e letërsi, po aq të

socialist u shfaq për herë të parë në vitin 1932 në Bashkimin Sovjetik dhe u kthye në teori mirëfilli në vitet 1932-34.

⁴⁶ Një shkrim interesant për realizmin socialist si arkiv në Shqipëri është ai i Raino Isto-s, “A është realizmi socialist një arkiv? Shënime teorike mbi estetikën dhe akumulimin”, *Studime për artin* nr. 19, 2020, f. 9-46. Boris Groys shpall se pavarësisht se pretendon të vijë nga masat për masat, realizmi socialist “për shkak se kishte synim të edukonte, ofronte didaktikë që nuk të tërhiqte, i mungonte vlera argëtuese dhe largohej nga jeta e vërtetë jo më pak se *Black Square* i Malevich-it”. Shiko: Groys, *The Total Art of Stalinism*, f. 8. Për Groys-in, stalinizmi (ose realizmi socialist nën Stalinin) ishte një vazhdimësi e modernizmit avangardë. Kufiri i kësaj teorie hartohet shkurtimisht nga Petre M. Petrov, *Automatic for the Masses: The Death of the Author and the Birth of Socialist Realism*, Toronto: University of Toronto Press, 2015, f. 4-7. Të tilla lidhje, por edhe largime mes avangardës dhe realizmit socialist diskutohen nga Imre József Balázs që merr si rast studimi Hungarinë dhe Rumaninë. Shiko: Imre József Balázs “From Avant-Garde to Socialist Realism: Continuities and Discontinuities in Hungarian and Romanian Literature”, në Evgeny Dobrenko and Natalia Jonsson-Skrodol, red., *Socialist Realism in Central and Eastern European Literatures*, f. 147-164. Vladislav Zubok argumenton se që prej viteve '20, Bashkimi Sovjetik organizoi një numër institucionesh që “do t’ua shisnin panoramën e realizmit socialist në Bashkimin Sovjetik intelektualëve të majtë perëndimorë... ky ‘realizëm socialist për eksport’ ishte efektiv, sepse u përgjigjej ideve dhe aspiratave të intelektualëve perëndimorë... në një kuptim, realizmi socialist ishte një degëzim i çuditshëm i kulturës perëndimore dhe i praktikave artistike”. Shiko: Vladislav Zubok, “The Demise of ‘Socialist Realism for Export’ in 1947: Voks Receives John Steinbeck and Robert Capa”, në Evgeny Dobrenko dhe Natalia Jonsson-Skrodol, red., *Socialist Realism in Central and Eastern European Literatures*, f. 71-88 (f. 71).

rëndësishme sa edhe vlerat socialiste që duhej të ngrinin. Kjo paradigmë ishte e përhapur edhe në vendet e tjera socialiste, përfshirë Bashkimin Sovjetik, nën strategjinë e krijimit të një arti që ishte “kombëtar në formë, por socialist në përmbajtje”.⁴⁷ Në letërsi dhe kinema historitë ndërtoheshin rreth një heroi, që zakonisht vinte nga shtresat e poshtme të shoqërisë, i cili luftonte të kapërcente pengesat dhe që gjithmonë nxirrte ngadhënjimtare të drejtën, shpesh me ndihmën e këshillave orientuese të partisë dhe të mësimëve të mençura të udhëheqësit të shtrenjtë. Dy subjekte u bënë qendrore në filma, traditat e vjetra e të prapambetura, që përqesheshin e dënoheshin (shiko komedi si *14 vjeç dhëndër* apo *Çifti i lumtur*) dhe heronjtë e Luftës së Dytë Botërore, që kishin gjithmonë në qendër rolin e partisë e të udhëheqësit të saj në çlirimin e vendit nga zgjedha fashiste (shiko, mes të tjerëve, *Lulëkuqet mbi mure* dhe *Ngadhënjim mbi vdekjen*). Në të dy rastet e subjekteve, mesazhi thelbësor ishte arritja e pavarësisë kombëtare, shpagimi shoqëror ndaj dhimbjeve të shkaktuara nga kufizimet e mëparshme politike, shoqërore e ekonomike dhe arritja e një jete të lumtur e përmbushëse nën socializëm, që e lejonte potencialin njerëzor të realizohej plotësisht, duke e larguar individin nga zakonet e vjetra që e frenonin këtë potencial.

Filmat, me në qendër figurën e partizanit, kishin edhe një mesazh të rëndësishëm. Ishin një mënyrë për të theksuar dallimin nga Bashkimi Sovjetik: në shumë vende të tjera socialiste të Evropës Lindore, lufta për çlirimin kombëtar i atribuohet qoftë

⁴⁷ Karolina Kluczevska dhe Niso Hojieva, “Socialist in Form, ‘National’ in Content? Art and Ideology in Soviet Tajikistan”, *Nationalities Papers* vëll. 50, nr. 2, mars 2022, f. 372- 394.

edhe pjesërisht kontributit të Ushtrisë së Kuqe, kurse në Shqipëri (dhe në Jugosllavi), partizanët kishin qenë bashkimi i një force popullore që kontribuoi në luftën kundër nazi-fashizmit pa përfshirjen e drejtpërdrejtë të Ushtrisë së Kuqe. Kësisoj, Shqipëria mund ta ndante veten nga satelitët e tjerë sovjetikë, duke theksuar rolin e partizanëve si një trashëgimi autentike dhe lokale antifashiste që kishte arritur mposhtjen e nazistëve.⁴⁸ Dhe, në këtë kuptim, mund të parashtronte një pozicion të ngjashëm me të jugosllavëve, edhe pse, sigurisht, të dy vendet morën drejtime shumë të ndryshme.

Një zhanër i ri që lindi gjatë kësaj periudhe ishin “filmat e vigjilencës revolucionare të masave”.⁴⁹ Këta ishin filma me hetues, ku veprimi zhvillohej kryesisht në zonat urbane, që zakonisht në rolet kyçe kishin burokratë dhe jo punëtorë, me përbërës ekzotikë të spiunazhit ndërkombëtar dhe, në nja dy raste, edhe skena të xhiruara në perëndim. Ky lloj filmi zor se merrej me *zakonet prapanike* apo heronjtë e Luftës së Dytë Botërore. Ata merreshin kryesisht me *mbeturinat mikroborgjeze*, si lidhja me modën, tendenca për të pirë ose seksi paramartesor. Ata mishëronin, gjithashtu, pjesëmarrjen e masave punonjëse në sistemin shqiptar të survejimit.⁵⁰ Të gjitha ndikimet e jashtme

⁴⁸ Raino Isto, “Weak Monumentality”, *Canadian Art Review* vëll. 46, nr. 2, 2021, f. 34-50.

⁴⁹ Jonida Gashi, “Communist Noir: The Hunt for Hidden Traitors, Saboteurs, Spies, Revisionists, and Deviationists in Albania’s Revolutionary Vigilance Films of the 1970s and 1980s”, në Sarah Delahousse dhe Aleksander Sedzielarz, red., *Transnational Crime Cinema*, Edinburg: Edinburg University Press, 2023, f. 125-139; dhe Jonida Gashi, *Kinemaja para gjyqit: Nga kinokronikat dhe dokumentarët e gjyqeve të popullit te filmat e vigjilencës revolucionare të masave*, Tiranë, 2024.

⁵⁰ Gashi, “Communist Noir”.

dhe *shfaqjet e huaja* ndaloheshin dhe sulmoheshin, veçanërisht ndikimi perëndimor, që portretizohej si thellësisht dekadent: një pasqyrë e veseve të shoqërisë kapitaliste.

Zelli i kësaj narrative kundër shfaqjeve të huaja kthehu në një viktimë të njohur Festivalin e Njëmbëdhjetë të Këngës, mbajtur në dhjetorin e vitit 1972, ku ndikimi xhaz e rok ishte më se i dukshëm (i dëgjueshëm).⁵¹ Udhëheqja e partisë u përfshi drejtpërsëdrejti në spastrimet ndaj artistëve dhe zyrtarëve partiakë që kishin në ngarkim çështjet kulturore. Disa përfunduan me dënime të gjata me burg, të tjerë qenë më fatlumë dhe u dërguan të punonin në kooperativa të largëta brenda vendit. Regjimi socialist në Shqipëri, ashtu siç argumenton Nicholas Tochka në studimin e tij mbi muzikën, hyri në një rrugë që “i kthente të gjitha fushat e krijimtarisë në forma ligjërimore që drejtoheshin nga qendra politike”.⁵² Mesazhi ishte i qartë: krijimtaria socialiste duhet të ishte e papërlyer nga shfaqjet e huaja dhe duhej të ngrihej mbi traditën vendase. Plenumi i partisë i vitit 1973, që vendosi për spastrimet në fushën e kulturës, në vijim të festivalit të dhjetorit 1972, mund të konsiderohet si përpjekja e arritur e partisë për të kontrolluar ndryshimet dhe

⁵¹ Shqipëria nuk ishte rast unik i ndikimit të muzikës perëndimore gjatë Luftës së Ftohtë, po mbetet unike për shkak të reagimit të partisë në pushtet ndaj këtyre ndikimeve. Shiko: Yvetta Kajanova, Gertrud Pickhan dhe Rudiger Ritter, red., *Jazz from Socialist Realism to Postmodernism*, Frankfurt am Main: Peter Lang, 2016, f. 13-198. Për festivalet e vitit 1972 shiko: Nicholas Tochka, *Audible States: Socialist Politics and Popular Music in Albania*, Nju Jork: Oxford University Press, 2016, f. 90-94 dhe f. 101-103.

⁵² Tochka, *Audible States*, f. 46. Tochka flet edhe për dallimet që solli Revolucioni Ideologjik dhe Kulturor në prodhimin muzikor në Shqipëri (f. 72-78). Një prej këtyre ndikimeve ishte ndryshmi i tematikave, që ngjiti në skenë, mes të tjerave, më shumë tekste që theksonin ngritjen materiale të socializmit, heronjtë pozitivë, heronj të Luftës së Dytë Botërore dhe këngë patriotike.

zellin e ndezur gjatë Revolucionit Ideologjik dhe Kulturor. Kjo ngjarje ishte pika kulmore e revolucionit, të paktën në fushën e kulturës, por edhe një shenjë se partia po u largohej politikave që kishin përkrahur debate të gjalla, prej të cilave ndikimet e huaja mund të ishin thithur në kulturën kombëtare, gjë që sfidonte fare hapur synimet e këtij revolucioni: luftën ndaj këtyre ndikimeve.

Për ironi, kthimi në traditë i artit dhe letërsisë shqiptare, i cili, mes të tjerave, synonte të theksonte vlerat e popullit shqiptar, ndiqte të njëjtën linjë me atë çka po ndodhte në Bashkimin Sovjetik gjatë po së njëjtës periudhë, pra, në vitet '60-'70. Atje, siç thotë Groys, “realizmi socialist filloi t’i dorëzohej realizmit tradicional... [me] fokus në ‘vlerat e përjetshme’ të mishëruara në popullin rus”.⁵³ Shumë autorë (ndër të cilët Groys-i përmend edhe Solzhenitsyn-in, që gjithashtu e refuzoi socializmin) pretendonin që këto vlera ishin ruajtur mirë nën modelin sovjetik, duke mos iu nënshtruar prishjes që vinte nga përparimi përëndimor dhe individualizmi. Megjithatë, në Shqipëri u zhvilluan debate të gjalla në arte dhe kulturë, veçanërisht në lidhje me krijimin letrar e muzikën, të cilat duhet të krijoheshin për masat.⁵⁴

IV. Gratë dhe feja

Në kuadrin e mobilizimit të masave për revolucionarizimin e mëtejshëm të vendit, dy fushata në veçanti prekën pjesë të mëdha të popullatës. E para sulmoi fenë; e dyta bëri një hap të madh para për emancipimin e grave.⁵⁵ Çështja e

⁵³ Groys, *The Total Art of Stalinism*, f. 76.

⁵⁴ Tochka, *Audible States*, f. 61-67.

⁵⁵ *Zëri i Popullit*, 7 Shkurt 1967.

fesë u diskutua për herë të parë seriozisht në nivelin qendror në plenumin e partisë të prillit 1949, gjatë të cilit Hoxha këshilloi kundër “luftës ndaj fesë me dekrete partie”, duke njohur edhe kontributin e klerit (të të gjitha feve) në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.⁵⁶ Në të njëjtën kohë, duke iu referuar Engelsit, partia e shihte luftën e klasave si të vetmin mjet “që mund ta shtyjë proletariatin drejt zbatimit të veprimit shoqëror deri në fund... i cili, përfundimisht, do ta çlirojë [popullin] nga shtypja e fesë”.⁵⁷ Që kur kishte ardhur në pushtet, PPSH-ja ishte përpjekur ta kufizonte fuqinë dhe ndikimin e fesë, por fushata e vitit 1967 sollti ndryshime rrënjësore në intensitetin dhe në shtrirjen e betejës kundër fesë, duke i kthyer ndryshimet sasiore në ndryshime cilësore. Kështu, duke zgjeruar dhe thelluar këto politika deri në pikën e ndalimit të fesë, të shpalljes së vendit si shteti i parë ateist në botë dhe të mobilizimit të masave për të shkatërruar shumicën e objekteve të kultit, u shkaktua një thyerje, duke e kthyer politikën në një *të re* dhe jo thjesht vazhdim i politikës së mëparshme.

Partia duhet të punonte me kujdes kundër fesë, sepse komuniteti i klerit ishte i organizuar dhe kishte rrënjë të thella në ndërgjegjen e njerëzve: ishte saktësisht “opiumi i populli, që e kishte helmuar, prandaj ishte detyrë [e partisë] që t’i shëronte”.⁵⁸ Në këtë betejë, autoritetet bënë dallime jetike. Për ta, “klerikët,

⁵⁶ Transkript i Plenumit të Dytë të Kongresit të Parë të Partisë, 28-30 prill 1949 në Tiranë, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1949, D.1, f. 13-14.

⁵⁷ Transkript i Plenumit të Dytë të Kongresit të Parë të Partisë, 28-30 prill 1949 në Tiranë, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1949, D.1, f. 14.

⁵⁸ Partia e Punës së Shqipërisë, Komiteti Qendror, Tiranë, 27 shkurt 1967. Për Komitetin e Partisë së Qarkut, në AQSH, F.511, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, V.1967, D.20, f. 2.

veç katolikëve (dhe ortodoksëve), ishin shumë injorantë dhe praktikimi i fesë bëhej përmes një liturgjie arkaike në arabisht që askush nuk arrinte ta kuptonte”, çka e bënte lehtësisht të sulmueshme. Kurse “kleri katolik” (dhe ortodoks) ishte “më i pasur”, i arsimuar dhe i disiplinuar, prandaj ishte më e vështirë të zhdukej.⁵⁹ Ky tipar tregon se si regjimi, për të arritur qëllimet e sulmit ndaj tyre, caktoi një lloj hierarkie mes feve, që kërkonin qasje të ndryshme, në varësi të komunitetit fetar.

Masat shtypëse ndaj feve kishin filluar që me vendosjen e rendit komunist në Shqipëri. Arsimiti i brezave të rinj të klerikëve ishte bërë i pamundur, sepse shkollat fetare brenda vendit ishin mbyllur dhe shkollimi jashtë vendit ndalohej, nëse nuk kishe një leje zyrtare, leje që regjimi nuk e lëshonte kurrë. Prandaj, asnjë prej klerikëve nuk mund të shkonte në Itali, që ka qenë gjithmonë selia e arsimimit katolik, sikurse shteti nuk i lejoi as anëtarët e feve të tjera që të ndiqnin studimet fetare jashtë vendit. Lëvizja e revolucionit kulturor u caktoi njerëzve detyrën e luftës kundër institucioneve ku njerëzit shkonin të luteshin, kundër kishave e xhamive dhe kundër gjithë brezit të fundit të klerikëve që ishin akoma gjallë. Komitetet lokale të partisë morën udhëzime që “të shkatërronin kishat, xhamitë, manastiret, tempujt, të vetmet vende ku kleri mund të takohej me besimtarët”.⁶⁰ Lufta kundër fesë duhet të vazhdonte me vendosmëri “derisa të arrihej zhdukja e plotë [e saj]”. Partia shfrytëzoi, ndër të tjera mjete, edhe nacionalizmin, duke e propaganduar si “një armë në duart tona kundër fesë, sepse islami ka qenë ideologjia e pushtuesve otomanë, feja e krishterë

⁵⁹ Po aty.

⁶⁰ Po aty.

ortodokse është ideologjia e shovinistëve grekë dhe feja katolike ishte ideologjia e fashistëve italianë”.⁶¹ Duke i lidhur këto fe me “armiqtë”, masat u shtynë t’i mohonin lidhjet dhe praktikat e tyre fetare. Por fushata kundër fesë u bë edhe pjesë e luftës së përgjithshme të klasave. Propaganda e vuri më së pari theksin te lidhjet e klerit me klasën e pronarëve dhe shfrytëzimin e masave. Si një hap të fundit, partia mbajti parasysh fuqinë e festave fetare dhe i zëvendësoi ato me “festa të reja socialiste”.⁶²

Udhëheqja i druhej pakënaqësive të njerëzve në lidhje me këtë politikë ateizmi, pasi mund t’i kthente ata kundër partisë, kështu që propaganda kësaj fushate i dha më pak hapësirë në median masive, krahasuar me politika të tjera të revolucionit kulturor. Vlen të theksohet se *Zëri i Popullit* rrallëherë i përmendte aksionet revolucionare të masave kundër fesë, ndërsa tregonte zell për të reklamuar iniciativa të tjera publike në artikuj thuajse të përditshëm përgjatë vitit 1967. Brezi i të moshuarve në veçanti nuk e mirëpriti këtë politikë, edhe pse nuk kishin rrugëzgjdhje tjetër, veçse të pajtoheshin me të, madje ndonjëherë detyroheshin edhe ta mbështetnin. E ndërjegjshme për këtë, partia dha udhëzime në seksionet lokale që të shmangeshin “diskutimet publike... gjithçka duhet bërë pa bujë”.⁶³ Kështu, beteja kundër fesë duhet të vazhdonte pa lëshuar pe, por nuk duhet të binte në sy. Partia i udhëzoi komitetet e rretheve të ishin

⁶¹ Artan R. Hoxha, *Communism, Atheism, and the Orthodox Church of Albania: Cooperation, Survival, and Suppression, 1945-1967*, Londër & Nju Jork, Routledge, 2022.

⁶² Tiranë, 27 shkurt 1967. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. Raport informues dhe letër e Komitetit Qendror në lidhje me luftën kundër fesë dhe masat për ta çuar më tej dhe festat e reja socialiste, në AQSH, F.511, V.1967, D.20, f. 12-20.

⁶³ AQSH, F.511, V.1967, D.20, f. 10.

të vendosur, por, nëse ishte e mundur, “të mos hynin apo hapnin konflikte të hapura me popullsinë”. Partia duhet t’i trajtonte ata që kishin ndjenja fetare “si mjeku që duhet të kurojë një sëmundje, i cili u kthen njerëzve gëzimin e jetës”.⁶⁴ Kështu, misioni që kishte marrë përsipër Partia, mund të karakterizohet si një mision që do të shpëtonte edhe njerëzit, edhe partinë.

Fushata kundër fesë solli brenda muajve të parë mbylljen e 2169 ndërtesave fetare, 740 xhamive, 765 kishave e manastireve dhe 530 monumenteve të feve të tjera. Pronat u konfiskuan menjëherë nga shteti.⁶⁵ Shumë prej këtyre godinave u rrafshuan, si katedralja madhështore ortodokse në qendër të Tiranës, ku shteti ngriti “Hotel Tiranën”, që gjatë sistemit gëzonte famën e godinës më të lartë në vend (15 kate) dhe sot mbetet një prej pikave të referimit të qytetit. Kjo ishte një mënyrë për të treguar se socializmi ngrihej edhe më i fortë mbi hirin e botës së vjetër. Nga gjithë godinat e kultit që u inspektuan në vitin 1967, vetëm 111 patën fatin të viheshin nën mbrojtjen e shtetit si trashëgimi kulturore, pas një inspektimi të dytë në vitin 1969.⁶⁶ Të tjerat, nëse nuk u rrafshuan, u kthyen në depo armësh, teatro të vogla ose stalla.⁶⁷ Disa patën fat më të mirë dhe shërbyen si hapësira për shtëpitë e kulturës.⁶⁸ Përdorimi i disa godinave

⁶⁴ Po aty, f. 2-8.

⁶⁵ Raport informues, 07 korrik 1967, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. Mbi rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe masat për ta çuar më tej, në AQSH, F.511, V.1967, D.20, f. 22; Dekret Nr. 4263 i Presidiumit të Asamblesë Kombëtare, në AQSH, F.511, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, V.1967, D.20, f. 20.

⁶⁶ AQSH, F.511, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, V. 1969, D.66, f. 18-20.

⁶⁷ Po aty, f. 73-80.

⁶⁸ Shtëpitë e Kulturës ishin hapësira që u kushtoheshin interpretimeve artistike, kryesisht këngëtarë, kërcimtarë dhe trupa teatrore, ku njerëzit

fetare për nevoja civile shpesh u diktua jo nga dëshira e mirë për t'i ruajtur, por sepse ndërtimi i godinave të reja, kushtonte. Shumica e klerikëve patën një fat të trishtë, pasi shumë u ekzekutuan me gjyqe farsë, kurse pjesa tjetër u dënua me vite të gjata burgosjeje dhe pune të detyruar. Kur ra regjimi, në vitet '91-'92, nga qindra klerikë të feve të ndryshme, kishin mbetur gjallë më pak se një duzinë.

Shkatërrimi i godinave historike fetare hasi rezistencë edhe nga Ministri i Arsimit dhe Kulturës, Thoma Deljana. Në qershor të vitit 1969, ai i shkroi një letër Enver Hoxhës, ku kërkonte më shumë kujdes dhe mbrojtje nga “kjo dëshirë e shfrenuar për të thelluar artificialisht Revolucionin Ideologjik dhe Kulturor, që po shkakton veprime të dhunshme e ekstreme... Në Vlorë, po ngulmohet të priset i vetmi monument i lashtë i qytetit, xhamia Muradije. Në Fier, duke u përpjekur të hiqnin kryqin në kishën e Shën Gjergjit, kanë shkatërruar gjithë arkitekturën... në Sarandë, kisha e epokës para otomane ishte kthyer në depo plehu... Është flagrant rasti i kishës së shekullit XIII të Vaut të Dejës [Qarku i Shkodrës] që u rrafshua me eksploziv”.⁶⁹ Në mbyllje të letrës, ai kërkonte që këto çështje të diskutoheshin në Byronë Politike. Në vitin 1975, Deljana do të binte pre e spastrimeve, por, në fillim të viteve '70, shqetësimet e tij mund të jenë marrë parasysh, teksa u zhvilluan debate që bënin thirrje për ruajtjen e disa godinave fetare, të cilat mund të

mblidheshin zakonisht pas pune të shijonin shfaqjet. Veprimtaria e tyre ishte punë propagandistike, duke qenë në kontrollin e partisë dhe shfaqjet zakonisht tregonin arritjet madhështore të jetës socialiste dhe nderonin vendlindjen. Ato gjendeshin në mbarë vendin, madje edhe në komunat më të vogla.

⁶⁹ Letër e Thoma Deljanës drejtuar shokut Enver, Tiranë, 24 qershor 1969, në AQSH F.511, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, V.1969, D.66, f. 67-68.

konsideroheshin si provë e trashëgimisë kulturore. Prandaj, disa prej tyre mbijetuan, përgjithësisht ato që kishin rëndësi historike në aspektin e arkitekturës, artit dhe historisë kombëtare.⁷⁰ Për më shumë, në vitin 1971 filloi të botohej *Monumentet*, një revistë që kishte në qendër trashëgiminë kulturore dhe arkitekturën. Këtu më së shumti botonin arkitektët e arkeologët dhe debatet e shkrimet e tyre tregojnë për interesin ndaj një arkitekture kombëtare, gjë që mundësoi ruajtjen e studimin e disa prej godinave fetare.⁷¹ Gjithsesi, letra e protestës së ministrit, nxjerr në pah mospërputhjet problematike (dhe domethënëse) mes analizave të revolucionit kulturor, që përqendrohen kryesisht te proceset e vendimmarrjes në nivelet më të larta dhe analizën e përvojës së jetuar të pjesëmarrësve, që nga zyrtarët e partisë e deri te viktimat e spastrimeve. Vështrimi mbi Revolucionin Ideologjik dhe Kulturor i përfutur nga ky tip i dytë analize, përshkuan një thyerje apo çarje mbi cilësinë e transformimit, gjë që nuk duket se arrihet nga analiza e parë.

Një tjetër synim i shpallur i Revolucionit Ideologjik dhe Kulturor në Shqipëri ishte emancipimi i gruas. Projekti i emancipimit nën Revolucionin Ideologjik dhe Kulturor u kthye në një përpjekje masive që përfshiu të gjitha shtresat shoqërore dhe përqendrohej jo vetëm te emancipimi i grave, por përpiquej të revolucionarizonte edhe mënyrën se si gratë shiheshin nga burrat.

⁷⁰ Tiranë, 11 shkurt 1969. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. Raport dhe listë finale e godinave fetare që mbeten nën mbrojtjen e shtetit, në AQSH, F.511, V.1969, D.66, f. 7-16 dhe f. 57-66.

⁷¹ *Monumentet* botohej nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Numri i parë i vitit 1971 deri në numrin 8 të viti 1974 gjenden në pdf në <http://iktk.gov.al/site/rreth-nesh/revista-monumentet-1971-1974/> [referuar më 8 maj 2023].

Që në nëntor të vitit 1966, gjatë Kongresit të Pestë të Partisë, Hoxha përmendi nevojën e hedhjes së një hapi të ndjeshëm në emancipimin e grave. Në fillim të shkurtit 1967, dy ditë pas kryeartikullit në *Zërin e Popullit*, u publikua një debat nga një komunë e vogël e Gjirokastrës, ku artikulli vërente se si njerëzit kishin kërkuar “heqjen e zgjedhës nga kurrizi [i grave]”.⁷² Në një tjetër artikull, në po atë të përditshme, theksoheshin veprimet e ndërmarra lokalisht për emancipimin e grave në mbarë vendin.⁷³ Fushata shtyu edhe ngritjen sociale, çuarjen e vajzave të reja në universitete dhe në vende pune në zonat urbane. Me synimin e nxjerrjes së grave nga traditat patriarkale e fetare (veçanërisht në zonat e thella të veriut të vendit), shumë të reja u mobilizuan të punonin në zona urbane, industriale ose infrastrukturore, të cilat i shërbenin edhe nevojës për të modernizuar gruan e re socialiste.

Pavarësisht fokusit të propagandës mbi barazinë mes burrave e grave, një ndër arsytet kryesore për projektin e emancipimit ishin problemet ekonomike. Udhëheqësit kinezë shumë herë vunë në dyshim nëse ky vend i vogël do të ishte në gjendje të mblidhte krahun e duhur të punës për projektet e shumta ekonomike që ata po financonin. Në disa pjesë të vendit, gratë ishin ende të përjashtuara nga jeta publike dhe nga mundësia për të mbajtur një sërë postesh. Në këtë aspekt, revolucioni synonte t’i integronte këto gra në sistemin ekonomik. Fushata nuk kishte lidhje me versionin kinez të emancipimit të grave, por ngjante më shumë me lëvizjen e viteve ’30 në Bashkimin Sovjetik, ku revolucioni nënkuptonte një riformulim

⁷² “Frymëmarrja e Fundit e një Mbeturine të së Kaluarës”, *Zëri i Popullit*, 9 shkurt 1967.

⁷³ ”Gratë – forcë e madhe shoqërore në ndërtimin e socializmit”, *Zëri i Popullit*, 19 shkurt 1967.

të rolit të grave në revolucion dhe shoqëri.⁷⁴

Por kishte edhe arsye të tjera, siç ishte kontrolli politik. Në një regjim, ku i vetmi autoritet që lejohej të udhëhiqte dhe të kontrollonte njerëzit ishte partia, lënia e një pjese të madhe të popullsisë së përbërë prej grave nën sundimin e anëtarëve meshkuj të familjes ishte e papranueshme. Në disa zona të thella të vendit, mblesëritë vazhdonin të lidheshin që në lindje dhe roli i grave në shoqëri rregullohej sipas këtyre normave arkaike. Kjo, për një pjesë të popullsisë, veçanërisht në fshat, donte të thoshte të jetoje jetë paralele, ku zakonet e vjetra ishin më të fuqishme se ligjet e shtetit. Kjo situatë nuk mund të tolerohej më nga regjimi. Popullsia, veçanërisht të rinjtë dhe ata të moshës së mesme, e mirëpritën këtë politikë dhe e mbështetën fushatën e emancipimit të grave. Megjithatë, edhe pse u çliruan nga kushtet e tyre të mëparshme skllavëruese, grave u mohoheshin shumë liri, për shkak të normave të qëndrueshme gjinore. Emancipimi i grave në Shqipëri ishte larg asaj për çka protestonin lëvizjet feministe në mbarë Evropën në fund të viteve '60, lëvizje mbi të cilat gratë shqiptare, shumica e të cilave ishin të izoluar dhe të painformuar, nuk kishin dijeni. Përkundrazi, shumë aspekte, të paktën formale, të jetës së grave në Shqipërinë socialiste, u ngjanin atyre të grave sovjetike gjatë gjysmës së dytë të viteve '30.⁷⁵ Për shembull, familjet u nxitën të kishin sa më shumë fëmijë, pasi shteti shpallte se do të mbështeste të gjitha

⁷⁴ Sheila Fitzpatrick dhe Yuri Slezkine, red., *In the Shadow of Revolution: Life Stories of Russian Women from 1917 to the Second World War*, Princeton, New Jersey: Princeton University Press, 2000, f. 167-434.

⁷⁵ Sheila Fitzpatrick, *Everyday Stalinism: Ordinary Life in Extraordinary Times: Soviet Russia in the 1930s*, Oxford: Oxford University Press, 2000, f. 142-156.

nevojat bazë për rritjen e tyre. Për këtë arsye, edhe pse aborti konsiderohej si e drejtë, nuk mbështetej, përveçse në rastet e rrezikut për jetën. Po ashtu, gjykatat e kohës e kufizuan mundësinë e divorcit, që teorikisht, u garantohej me të drejta të plota grave (dhe burrave), nëpërmjet përpjekjeve për t'i pajtuar çiftet, para se të jepej e drejta për t'u ndarë.⁷⁶ Gjithsesi, fushata nxiti barazinë në lidhje me pjesëmarrjen e grave në jetën publike dhe u dha atyre mundësinë të zinin pozicione të rëndësishme.

V. Të përgatitur për punë dhe luftë

Një prej rezultateve të revolucionit kulturor në Shqipëri ishte rritja e prodhimit ekonomik. Me ngritjen e projekteve të mëdha industriale, zbatueshmëria e të cilave shpesh u vu në dyshim, Revolucioni Ideologjik dhe Kulturor në Shqipëri u bë një mjet i ngritjes shoqërore për mijëra punëtorë, që tani mund të ndiqnin arsimin e mesëm e të lartë dhe të kapnin pozicione më të larta, si detyra menaxhimi dhe administrimi, që shpesh ishin në zonat urbane. Gjithsesi, pranimi në arsimin universitar kufizohej në një numër të vogël njerëzish në proporcion me popullatën. Biografia politike e familjes dhe anëtarësimi në parti, që vetë ishte burim pështjellimi, luanin rol thelbësor. Por kjo ishte një nga mënyrat kryesore për të përparuar në shoqëri, ashtu si edhe në Bashkimin Sovjetik dhe në shumicën e vendeve socialiste.⁷⁷

Vetëm për Planin e Katërt Pesëvjeçar (1966-1970), partia planifikoi ndërtimin e rreth 60 komplekseve të mëdha industriale,

⁷⁶ Luljeta Ikonimi dhe Shannon Woodcock, “Imoraliteti në Familje: Nxitja e Ankesave të Grave për të Përforcuar Pushtetin e Partisë në Revolucionin Kulturor Shqiptar”, *Përpjekja* vëll. 20, nr. 32-33, 2014, f. 155-182.

⁷⁷ Sheila Fitzpatrick, *Everyday Stalinism*, f. 16.

përveç disa projekteve të vogla në industrinë e lehtë si dhe ndërtimin e digave, rrugëve e hekurudhave.⁷⁸ Regjimi fillimisht kishte premtuar një të ardhme të begatë, por duke ofruar vazhdimisht një të tashme me mungesa, autoritetet duhet t'i rishikonin këto premtime. Politikisht partia filloi t'i dënonte ata që kërkonin mirëqenie materiale. Partia u përpoq të zhdukte çdo formë të pavarësisë ekonomike individuale, në emër të jetesës kolektive spartane. Hoxha thoshte se komunistët “duhet të jenë të parët në sakrifica e të fundit në pretendime... çdo koncept revizionist e borgjez në jetë, që vë në plan të parë paratë, luksin, rehatinë dhe mirëqenien personale, duhet të jetë i huaj për njerëzit tanë”.⁷⁹ E megjithatë, hovi industrializues i viteve '60-'70, i përtëriu pritshmëritë e njerëzve se e ardhmja mund të sillte mirëqenie materiale, nëse secili luante rolin e tij. Prandaj, mijëra njerëz iu përgjigjën thirrjes për të marrë pjesë në *aksione*, duke dhënë kontributin e tyre, shpesh me punë krahu, për realizimin e projekteve industriale dhe infrastrukturore në mbarë vendin. Ata kryenin detyra që nuk kërkonin ndonjë aftësi apo trajnim të veçantë, duke përdorur muskujt në vend të pajisjeve të nevojshme, si makineritë për heqjen e sasive të mëdha të dheut apo të mbeturinave, sikurse hapnin rrugë të reja në mungesë të lopatave dhe kazmave. Fushata u shpall fillimisht e suksesshme. Për shembull, në qarkun e Korçës u raportua se forca punëtore në projektet ekonomike ishte rritur nga 20 000 në 25 000 vetë dhe se kishte vend për rritje të mëtejshme. Kjo forcë punëtore kishte mundësuar tejkalimin e objektivave të planit dhe kishte

⁷⁸ Dokumente të Byrosë Politike, 11 tetor 1966, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.21, f. 48.

⁷⁹ Po aty, f. 136-137.

kontribuar në rritjen e tokave bujqësore.⁸⁰ Një tjetër çështje që adresonte kjo fushatë ishte ajo e papunësisë. Vetëm në qytetin e Korçës kishte rreth 2000-3000 të rinj të papunë. Kjo situatë ishte e ngjashme në shumë zona urbane të Shqipërisë: të njëjtat raportime vinin edhe nga zyrtarët e partisë në Durrës, Shkodër, Dibër, Fier, Vlorë dhe qarqe të tjera.⁸¹ Kështu, kjo fushatë shpërndau forcën punëtore urbane që ishte e papunë si pasojë e rritjes së popullsisë pas Luftës së Dytë Botërore.

Të rinjtë shqiptarë, që përbënin pjesën dërrmuese të pjesëmarrësve në këto *aksione*, u ngjanin të rinjve të arsimuar kinezë (*zhiqing*) që dërgoheshin nga zonat urbane drejt fshatrave.⁸² Në Shqipëri, iniciativa për të dërguar njerëzit nga qyteti në fshatra u prit me njëfarë rezistence, pasi njerëzit përpiqeshin t'i shmangnin lëvizje të tilla.⁸³ Po regjimi kishte nevojë të unifikonte dallimin kulturor mes zonave veriore e jugore të vendit. Prandaj shkëmbimet bëheshin mes veriorëve që shkonin përkohësisht në jug dhe anasjelltas. Edhe ndryshime të tjera ngjasonin dukshëm me ato të Kinës: që prej pranverës së vitit 1966, fizkultura u shpërnda gjithandej mes kolektivave të punës e institucioneve shtetërore dhe shpesh bëhej para godinave

⁸⁰ Tiranë, 4 mars 1966. Minuta të mbledhjes së plenumit të partisë, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.9, f. 133.

⁸¹ Po aty, f. 134.

⁸² Tania Branigan, *Red Memory: Living, Remembering, and Forgetting China's Cultural Revolution*, Londër: Guardian Faber Publishing, 2023; Guobin Yang "China's Zhiqing Generation: Nostalgia, Identity, and Cultural Resistance in the 1990s", *Modern China* vëll. 23, nr. 3, 2003, f. 267-296.

⁸³ Tiranë, 4 mars 1966. Minuta të plenumit të partisë, në AQSH, F.14, AP-OU, V.1966, D.9, f. 129.

të punës, herët në mëngjes.⁸⁴ Në sistemin arsimor, që të gjitha shkollat futën përgatitjen ushtarake (*zborin*) për të forcuar përgatitjen fizike të nxënësve, duke zhvilluar një mendësi shtetrrëthimi në mbarë vendin.⁸⁵ Gjithsesi, kishte një dallim thelbësor me Kinën. Revolucioni kulturor kinez shkaktoi një çrregullim të fortë në sektorin e arsimit dhe solli mbylljen e universiteteve për shumë vite. Në të kundërt, revolucioni kulturor në Shqipëri promovoi edhe më tej arsimin dhe synoi të krijonte një klasë intelektuale proletare, që mund të ngrinte nivelin kulturor dhe aftësitë teknike të masave. Udhëheqësit shqiptarë kuptuan se, ashtu siç kishte thënë kohë më parë Gail Warshofsky Lapidus-i, në studimin e tij për Bashkimin Sovjetik, arsimi ishte “çelësi i revolucionit kulturor që do të krijonte një shoqëri sa socialiste, aq edhe moderne”.⁸⁶ Në Shqipëri, arsimi u kthye në një pikë të rëndësishme ku theksohej fuqia e shkencës dhe e teknologjisë. Por ai luajti edhe një rol madhor në rimodelimin e funksionit të studimit të shkencave humane, përmes përpunimit të traditës, rrëfimeve orale dhe miteve kombëtare, pasi rishkroi me kujdes narrativën e saj, jo më si një përjetësim i vlerave dhe hierarkive të vjetra shoqërore, po si një mjet i farkëtimit të njeriut të ri socialist e nacionalist.⁸⁷

⁸⁴ Tiranë, 6 korrik 1966. Ministria e Arsimit dhe e kulturës – Drejtoria e kulturës fizike dhe sporteve. Letër drejtuar gjithë qarqeve mbi metodën dhe stilin në punë, në AQSH, f. 511, Ministria e Arsimit, V.1966, D.48, f. 2-15.

⁸⁵ Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, 6 korrik 1966. Raport mbi metodën dhe stilin në punë drejtuar gjithë qarqeve, në AQSH, f. 511, V.1966, D.48.

⁸⁶ Gail Warshofsky Lapidus, “Educational Strategies and Cultural Revolution: The Politics of Soviet Development”, në Sheila Fitzpatrick, red., *Cultural Revolution in Russia*, f. 78-104 (f. 80).

⁸⁷ Kenneth Jowitt kohë më parë ka argumentuar se të gjitha sistemet leniniste, “kanë interes në riprezantimin e përzgjedhur të traditës vetëm pasi rëndësia

Gjithsesi, lëvizja e njerëzve shkonte në dy drejtime. Ashtu si fushata të caktuara mobilizonin njerëzit që të shkonin nga zonat urbane në projekte specifike rurale ose kooperativa, kishte edhe një lëvizje që i sillte njerëzit rreth vendbanimeve të reja urbane. Ashtu si edhe në rastin sovjetik e kinez, në çastin që ndërtimi industrial u bë përparësi e planeve pesëvjeçare gjatë viteve '60-'70, ndërtimi i qyteteve rreth këtyre projekteve, ishte po aq i rëndësishëm.⁸⁸ Kjo nxitje drejt ndërtimit mori trajtat e qytetërimit socialist, me gjithçka që sillte pas, ashtu si edhe eksperimentimi i viteve '30 në Bashkimin Sovjetik.⁸⁹ Vendbanimet e reja urbane në Shqipëri ngritur rreth projekteve industriale, u bënë mekanizma dhe projekte politike që krijuan një formë të re bashkëjetese në komunitet. Ky zell ndërtimi që vazhdoi gjatë viteve '60-'70, krijoi hapësira të reja urbane, forma të reja të pjesëmarrjes shoqërore dhe politike, që nuk ngjasonin me ato të kooperativave në fshatra. Profesionistët dhe specialistët do të shndërroheshin në proletarë dhe detyrat e tyre tani morën një dimension të ri, atë të misionit të ndërtimit të socializmit. Mosangazhimi politik filloi të shihej me dyshim dhe militantizmi politik u kthye në normë.

Në ndryshim nga Kina, ku në valën e parë të revolucionit

politike e traditës është ndryshuar përfundimisht". Shiko: Kenneth Jowitz, *Revolutionary Breakthroughs and National Development*, Berkeley dhe Los Angeles, 1971, f. 115. Cit. në Gail Warshofsky Lapidus, "Educational Strategies and Cultural Revolution: The Politics of Soviet Development", f. 100.

⁸⁸ Fitzpatrick, *Everyday Stalinism*, f. 45-54.

⁸⁹ Stephen Kotkin, *Magnetic Mountain: Stalinism as a Civilization*, Berkeley: University of California Press, 1995. Studimi i Kotkin-it përqendrohet në ndërtimi i qytetit të ri të Magnitogorsk në Urale dhe të kombinatit të çelikut, një prej qendrave më të mëdha industriale të kohës në Bashkimin Sovjetik.

kulturor ekonomia pati probleme madhore, në Shqipëri prodhimi ekonomik gjatë kësaj periudhe u rrit në mënyrë të konsiderueshme. Shumë prej punëve infrastrukturore u përfunduan. Për të rritur prodhimet bujqësore e blegtorale, Shqipëria i pakësoi në mënyrë drastike kopshtet personale, që ishin ngastra të vogla toke rreth shtëpive dhe shumica e ekonomisë fshatare u shndërrua në prodhim të përbashkët bujqësor e blegtoral. Këto masa, sado të vështira, konsideroheshin të nevojshme, sepse ishte e vetmja mënyrë “për të shkatërruar mbetjet feudalo-borgjeze”.⁹⁰ Kjo qasje nga lart-poshtë në kolektivizimin e pronës në të gjitha nivelet e zotërimit të tokës, përfshirë edhe ngastrat e vogla që fshatarët kishin në male, bashkë me tufat e tyre të bagëtive, solli si përfundim varfërimin e shumë familjeve fshatare.

VI. Zbatimi i revolucionit

Njëra prej mënyrave të zbatimit të revolucionit në Shqipëri ishte përdorimi i versionit shqiptar të *dazibao*-s, e njohur si *fletërrufeja*.⁹¹ *Fletërrufetë* ishin gazeta muri ose fletë që

⁹⁰ “Të gjithë me të gjitha forcat për revolucionarizimin e mëtejshëm të partisë dhe të pushtetit”, *Zëri i Popullit*, 11 shkurt 1967.

⁹¹ “Iniciativë revolucionare e nxënësve dhe pedagogëve të shkollës ‘Naim Frashëri’ në Durrës. Në shpatën e mprehtë të ideologjisë së partisë kundër ideologjisë fetare, paragjykimeve, bestytnive e zakoneve prapanike”, *Zëri i Popullit*, 8 shkurt 1967. Në lidhje me fenomenin e *dazibao*-ve në Kinë, shiko kontributet e fundit të Xing Lu: Lu Xing, *Rhetoric of the Chinese Cultural Revolution: The Impact on Chinese Thought, Culture, and Communication*, Columbia, South Carolina: University of South Carolina Press, 2004, f. 28-50. Për një shpjegim të shpejtë të termit *dazibao* shiko informacionin e plotë në faqen e internetit të Fairbank Center for Chinese Studies në Harvard University: [https://fairbank.fas.harvard.edu/research/exhibitions/dazibao-](https://fairbank.fas.harvard.edu/research/exhibitions/dazibao-78)

ngjiteshin në mure publike, ku kritikohesh, po ndonjëherë edhe sulmohej, dikush a diçka. Atyre u jepej rëndësi e veçantë, pasi shërbenin si “mjete të fuqishme për edukimin ideologjiko-politik dhe moral të masave”.⁹² Mobilizimi i nxënësve dhe *fletërrufetë* ishin padyshim të ngjashme me praktikatat e revolucionit kulturor në Kinë. Dallimi me Kinën qëndronte në faktin se këto *fletërrufe* nuk u instrumentalizuan nga grupime të ndryshme për të luftuar kundër njëri-tjetrit dhe as frymëzuan dhunë fizike si *dazibao*-t në Kinë. Të rinjtë shqiptarë nuk e patën kurrë fuqinë e Gardistëve të Kuq kinezë dhe kurrë nuk luajtën rol aq të madh. Për këtë arsye edhe ngjashmëria është mjaft e kufizuar.

Një tjetër praktikë që u përhap gjerësisht ishte nxitja e seancave të “llogaridhënies”, ku bëhej autokritikë nga zyrtarë të partisë dhe njerëz me detyra e përgjegjësi të niveleve të ndryshme. Kjo kërkonte debate të hapura në organizatat bazë të partisë, që ishin krijuar pranë çdo njësie ekonomike, fabrike, institucioni apo komune. Në këto organizata, masat mund të përmbushnin rolin e tyre të vërtetë në seanca kritike kolektive, që ngjasonin me ato që zhvilloheshin në Kinë (*struggle sessions*). Në këto seanca llogaridhënieje dhe kritike, që zhvilloheshin në të gjitha vendbanimet urbane e në zonat rurale, viheshin në shënjestër ish-pronarë tokash, profesionistë nga radhët e proletariatit industrial dhe zyrtarë lokalë të partisë. Gjithsesi, Hoxha udhëzoi që këto seanca të mos ktheheshin kurrë në sheshe betejash, sepse “partia jonë nuk është fushëbetejë e zhvillimit të luftës së klasave”. Prandaj, këto seanca rrallë përfundonin në akte

and-woodcuts-from-1960s-china/.

⁹² “T’i bëjmë fletë-rrufetë një mjet të fuqishëm për edukimin ideopolitik e moral të masave”, *Zëri i Popullit*, 1 prill 1967.

dhune fizike kolektive kundër shënjestrave të paracaktuara. Sipas Hoxhës, revizionizmi nuk erdhi kurrë në fuqi në Shqipëri, pikërisht për shkak të këtyre rregullave dhe sepse “partia nuk është strofka e njerëzve pa ideologji”. Prandaj është e qartë se, në ndryshim nga Kina, në Shqipëri, udhëheqja e shihte veten mbi masat dhe nuk mund të ishte subjekt i kritikave të tyre, sepse “partia jonë i ka themelet... në centralizmin demokratik... në centralizimin e udhëheqjes... Gjithë organet e tjera duhet të binden e të zbatojnë vendimet e saj”.⁹³ E megjithatë, duke përcaktuar kornizën e çdo seance kritike dhe llogaridhënieje që duhet të zhvillohej, partia parandalonte devijimin e tyre në forume ku mund të vihej në dyshim vija e partisë.

VII. Konkluzione: revolucion pa përfundim

Ndërsa revolucioni kulturor në Kinë u mbyll zyrtarisht në vitin 1976, edhe pse për Maon ishte mbyllur që në 1969-n, revolucioni kulturor në Shqipëri nuk pati të njëjtën mbyllje. Në një kuptim, formalisht ai nuk pati as fillim. Nga ana tjetër, Revolucioni Ideologjik dhe Kulturor shqiptar, përmes një ideologjizimi bindës të të gjitha aspekteve jetësore krijoi mundësinë që partia të kaliste e t’i jepte formë një brezi të ri besnikësh ndaj partisë, të cilët kishin lindur pas Luftës së Dytë Botërore, ndaj kishin më pak ndikim nga e shkuara e largët. Kjo ishte mbase trashëgimia që la revolucioni për regjimin e Hoxhës dhe atë vetë. Në fakt, në fund të jetës së tij, pasi spastroi të gjithë shokët e tij të një jete, rreth tij mbetën vetëm më besnikët. Pas vdekjes së tij, premtimi i parë që ata u bënë shqiptarëve, ishte se

⁹³ *Zëri i Popullit*, 7 shkurt 1967.

do të ndiqnin gjithmonë vijën e Hoxhës. Në fakt, vijimësia kishte qenë një shenjë e regjimit socialist që në themelim të tij. Revolucioni kulturor në Shqipëri u zbatua nën rrethanat e favorshme të vazhimit të politikave socialiste të partisë. Në këtë kuptim, ishte më pak përthyes se sa eksperimentet nën të njëjtin emër në Bashkimin Sovjetik gjatë Planit të Parë Pesëvjeçar (1928-1932) dhe atij që u zhvillua në Kinë në mes të viteve '60. Në Shqipëri improvisimi, eksperimentimi dhe iniciativat nga poshtë u kufizuan në politika me shënjestra të qarta dhe projekte specifike në ekonomi. Në njëfarë mënyre, revolucioni synonte të përforconte dhe të çonte më tej çfarë ishte arritur nën socializëm, se sa të krijonte thyerje dhe një fillim të ri, siç ndodhi me eksperimentin sovjetik e kinez. Për më tepër, pluralizmi shqiptar në sferën sociale, intelektuale dhe kulturore kontrollohej me rigorozitet që në vitet e para të sundimit komunist. Synimi i tij ishte të sillte në një vijë forcat e ndryshme të shoqërisë me politikatat ideologjike dhe ekonomike të regjimit.

Gjithsesi, tekefundit, Revolucioni Ideologjik dhe Kulturor shqiptar përfundoi t'i ngjante më shumë eksperimentit të Bashkimit Sovjetik në vitet '30, se sa revolucionit kulturor të Kinës të viteve '60. Kjo reflekton ngjashmëritë e shumta në shoqëri mes Bashkimit Sovjetik të viteve '30 dhe Shqipërisë së pas Luftës së Dytë Botërore, si (mes të tjerave) një parti e krijuar nga një klasë e fortë punëtore urbane (edhe pse e vogël), domosdoshmëria për të ngritur industri të rëndë dhe udhëheqja e fortë. Por tregon edhe si udhëheqësi komunist shqiptar, Enver Hoxha, kishte po ato synime politike që kishte Stalini në vitet '30, që do të thotë konsolidim të pushtetit politik personal. Kjo nuk do të thotë se mungonin iniciativat nga poshtë, përkundrazi. Por

njerëzit përfshiheshin vetëm pasi këto iniciativa miratoheshin në nivel qendror. Për më shumë, ato shpesh u përgjigjeshin nevojave ekonomike e të prodhimit, në vend që të zhvillonin shenja të pluralizmit e debatit shoqëror. Në fund, fushatat masive dhe përfshirja e njerëzve forcuan partinë e udhëheqësit e saj dhe, deri diku rritën prodhimin ekonomik, përmes përfshirjes në shkallë të gjerë të forcës punëtore nga shtresa të shumta të shoqërisë, siç ishin gratë. Dhe për ta mbyllur, Revolucioni Ideologjik dhe Kulturor në Shqipëri kishte më shumë lidhje me ideologjinë, politikën dhe ekonominë, se sa me kulturën. Ai u shërbeu synimeve të partisë për të ruajtur një linjë të patrazuar veprimi, pa ndërhyrje dhe ndikime të jashtme, që mund ta kishin gërryer nga themelet. Si rezultat i këtij revolucioni, Shqipëria u izolua gjithmonë e më shumë, me të rinjtë më pak të ekspozuar ndaj ndikimeve të huaja që konsideroheshin të rrezikshme, duke bërë që gjithandej të mbizotëronte një ndjesi e përgjithshme dorëzimi.⁹⁴

⁹⁴ Dua të falënderoj kryeredaktoren e revistës, Jonida Gashi, për komentet e saj të vyera dhe për kohën e shpenzuar për rishikimin e disa versioneve të këtij artikulli. I jam shumë mirënjohës Raino Isto-s për ndihmën e tij bujare me burimet e shumta të përdorura këtu dhe për komentet e tij në versionin e parë dhe të dytë të artikullit. Shumë faleminderit edhe Anxhela Çikopanos për ndihmën e saj në përkthimin e artikullit në shqip.